

RAPORT VJETOR

2012

Raport vjetor i Komitetit të Helsinkit të RM-së për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë në vitin 2012

SHKUP, Qershor 2013

HYRJE.....	5
I. GJYQËSORI.....	6
1. Gjykata administrative.....	7
2. Presion nga pushteti ekzekutiv	7
3. Jotransparencë e gjyqeve në rastet e dëshmitarëve tashmë të mbrojtur	8
4. Gjyqet nuk kushtojnë kujdes të duhur në rastet e dhunës familjare	9
II. LEGJISLACIONI	10
1. Ligj për regjistrin e veçantë për personat e gjykuar për pedofili	11
2. Ligji për përgjimin e komunikimeve	11
3. Ligji për policinë	12
4. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve	13
5. Ligji për punësim dhe sigurimi në rast të papunësisë	13
III. VEPRIMI POLICOR	15
1. Vrasje e dyfishtë në Gostivar	16
2. Aksioni policor „Monstra“	16
IV. LISTRIMI	18
V. DISKRIMINIMI	22
1. Hyrje	23
2. Trendet dhe grupet e cënueshme	23
VI. LIRIA E SHPREHJES DHE LIRIA E MEDIAVE	25
1. Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje - hyrje në cenzurë?.....	26
2. Gjuha e urrejtjes	27
VII. INSTITUCIONET E MBYLLURA.....	28
1. Tortura ndaj të paraburgosurve në burgun e hetimeve	29
2. Mbrojtja shëndetësore	29
3. Ndihma juridike	30
4. Rikonstruimi i burgjeve	30
5. Institutet psikiatrike.....	31
VIII. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE	32
1. Nisma qytetare AMAN	33
2. Komisioni rregullator i energjisë	34
3. Ndihma financiare sociale.....	35

IX. TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE.....	36
1. Presionet politike dhe pengimi i protestës së qetë të nismave qytetare dhe aktivistëve ..	37
.	
2. Goditje mbi rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë-24.12.2012	40
3. Të burgosurit politikë dhe presioni politik	41
4. Shkelja e parimit të sekularizmit të shtetit.....	45
X. KOMUNITETI LGBTI	47
1. Hyrje	48
2. Qendra për mbështetje LGBTI	48
3. Homofobia	49
4. Avokimi dhe lobimi.....	50
5. Ndihma juridike	51
6. Sulme ndaj Qendrës	53
7. Mediumet.....	55
8. Institucionet	56
9. Bashkësitë	57

HYRJE

Në pajtim me misionin e vet, monitorim i situatës së të drejtave dhe lirive të njeriut në RM, Komiteti i Helsinkit çdo vit boton Raport Vjetor në të cilin paraqet pikëpamjet dhe mendimet në lidhje me të gjitha fushat ku janë prekur të drejtat dhe liritë e njeriut. Raporti i vitit 2012 është gjithashtu një përmbledhje e punës së Komitetit gjatë gjithë vitit në drejtim të monitorimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për çka kemi njohtuar në raportet mujore. Vlerësimi është se në vitin 2012, u gjetën shkelje serioze të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe shkelje drastike të parimit të sundimit të së drejtës dhe shtetit juridik. Ajo që shqetëson veçanërisht, është se gjatë vitit raportues shkeljet e regjistruara të të drejtave dhe lirive të njeriut tregojnë jo vetëm probleme sistemore në funksionimin e organeve dhe institucioneve, por edhe keqpërdorim të kompetencave të tyre. Raporti vjetor paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjeve të konstatuara me të drejtat e njeriut në fushat e mëposhtme:

-
- Gjyqësori
 - Legjislacioni
 - Veprimi policer
 - Lustrimi
 - Diskriminimi
 - Liria e medimeve dhe liria e shprehjes
 - Institucionet e mbyllura
 - Të drejtat ekonomike dhe sociale
 - Të drejtat dhe liritë civile dhe politike
 - Komuniteti LGBT
-

Duke marrë parasysh që Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara garantojnë mundësinë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Komiteti i Helsinkit do të vazhdojë të monitorojë situatat me të drejtat e njeriut, t'i promovojë ato dhe t'u sigurojë mbrojtje juridike qytetarëve të cilëve u janë cënuar të drejtat dhe liritë.

I. GJYQËSORI

1. Gjykata Administrative

Duke vepruar sipas kërkesave për ndihmë juridike falas, lidhur me fushat e rregulluara me procedurën administrative, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2012 monitoroi punën e Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë. Duke pasur parasysh lëndët e arritura, Komiteti i Helsinkit konstatoi se organet administrative dhe Gjykata Administrative e shkelin të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Gjegjësisht, kërkesa për ndihmë juridike falas për shkak të shkeljes së kësaj të drejte, dorëzuan persona të cilët tashmë 17 vjet zhvillojnë procedura kundër organeve administrative për realizimin e të drejtave të tyre, të cilat Gjykata Administrative nuk arriti t'i mbrojtë¹. Në disa raste, Gjykata Administrative ka marrë madje nga 6 vendime me të cilat i anulon vendimet e organeve administrative, por ato nuk janë zbatuar e as nuk janë respektuar, që do të thotë se janë marrë vendime që janë në kundërshtim me udhëzimet e Gjykatës Administrative. Andaj, shtrohet pyetja e respektimit të Gjykatës Administrative nga ana e organeve administrative? A e njohin ata nenin 5 të Ligjit për Kontestet Administrative, sipas të cilit vendimet e gjykatave në kontestet administrative janë të detyrueshme dhe ekzekutive? Ose, për shembull, për nenin 52, sipas të cilit, kur gjykata anulon një akt, organi kompetent është i detyruar të miratojë një akt të ri pa vonesë, dhe jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Gjatë kësaj, organi kompetent është i lidhur me mendimin juridik të gjykatës, si dhe me vërejtjet e gjykatës në lidhje me procedurën. Gjithashtu është e paqartë pse Gjykata Administrative nuk zbaton dispozitat ligjore që i lejojnë asaj të vendosë lidhur me kontestin dhe të marrë një vendim bazuar në faktet? Besojmë se nëse Gjykata Administrative tregon guxim për të zbatuar këto dispozita, rrethi vicioz që ndodh në rastet e anulimit të akteve të diskutueshme administrative nga gjykata, do të ndërpritet, gjë që do t'u lejojë qytetarëve të vijnë më shpejtë deri te drejtësia dhe shteti nuk do të pësojë dëme për shkak të gjykimit me afat të paarsyeshëm.

2. Presioni nga pushteti ekzekutiv

Duke përcjellë punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut konkludon se Gjyqësori është nën ndikimin e vazhdueshëm të pushtetit ekzekutiv dhe për këtë gjykatat dështojnë të mbrojnë të drejtat e qytetarëve, dhe në disa procedura nuk sigurojnë një gjykim të drejtë dhe fer. Prandaj, nuk mund të mos përmendim kufizimin e të drejtës për grevë të punëtorëve shëndetësorë nga Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë. Gjegjësisht, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut konsideron se me këtë vendim Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup pa të drejtë parandaloi grevën e paralajmëruar, me çka drejtpërsëdrejti rrezikoi të drejtën e grevës të garantuar me Kushtetutë. Sipas nenit 287 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, është detyrë e drejtorit të sigurojë kujdes mjekësor urgjent dhe funksion minimal për të gjitha njësitë organizative në

1 Shikoni pjesën rastet gjyqësore - Sllavčo Mitevski dhe Stamen Filipov

procesin e punës. Drejtorët, që nga data 07.09.2012 deri më 24.09.2012, kur duhej të fillonte greva, kishin kohë të mjaftueshme të përpilojnë një orar pune dhe të organizojnë një funksion minimal të të gjitha njësive organizative. Periudha kohore prej 18 ditësh që nga njoftimi e deri në ditën e grevës, madje e tejkalon edhe kuptimin e fjalës urgjente. Gjithashtu, nga përm-bajtja e vendimit është e qartë që sindikata propozoi që drejtorët të miratojnë akte konkrete për organizim në institucionet shëndetësore, por nuk morrën kurrfarë përgjigje. Propozimet e tilla për zgjidhjen e situatës që do të ndodhte gjatë grevës, kishin për qëllim që në asnjë mo-ment të mos rrezikohet shëndeti i asnjë qytetari, që dëshmon se nga ana e Sindikatës është respektuar neni 286 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore, i cili i referohet të drejtës për grevë, si dhe neni 287, paragrafi 2, sipas të cilit punonjësit janë të detyruar të veprojnë sipas masave përkatëse. Me këtë vendim, gjykata e shkallës së parë lejoi abuzim me ligjin dhe i dha legjiti-mitet mosveprimit të drejtorëve të spitaleve dhe në mënyrë të pabazë kufizoi realizimin e të drejtës për grevë, e cila garantohet me Kushtetutë, Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

3. Mostransparenca e gjykatave në rastet e dëshmitarëve tashmë të mbrojtur

Komiteti i Helsinkit, tashmë një kohë të gjatë, monitoron procesin e zbatimit të institutit „dësh-mitar i mbrojtur”, si zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, ash-tu edhe procedurën e marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve para gjykatës dhe ndikimin e tyre në parimin e gjykimit të drejtë dhe fer.

Duke përcjellë procesin gjyqësor për vrasjen e Marijan Tushevskit dhe Kiro Janevit, në 2001, në të cilin u akuzuan 15 persona, tre prej të cilëve për ekzekutim të drejtpërdrejtë dhe 12 të tjerët për ndihmë, duke përfshirë edhe Ljube Boshkovskin (asokohe Ministër i Brendshëm), përsëri ishim dëshmitarë të përjashtimit të publikut nga marrja në pyetje e dëshmitarit të mbrojtur nën pseudonimin „FF15”. Prokurorja publike, si përfaqësuese e prokurorisë dhe propozuese e dëshmitarit, dha pëlqim që opinioni profesional nuk duhet të përjashtohet nga marrja në pyet-je e dëshmitarit të mbrojtur. Me këtë për herë të parë nga ana e prokurorisë publike u tregua vullnet për një transparencë më të madhe në procedurën e marrjes në pyetje të një dëshmi-tari të mbrojtur. Megjithatë, këshilli vendosi të përjashtojë plotësisht publikun, përfshirë edhe prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, Profesor i Procedurës Penale në Fakultetin e Drejtësisë Justiniani I, pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi”, si përfaqësues i opinionit profesional.

Mendojmë që vendimet e vazhdueshme të këshillave për të përjashtuar publikun në rastet kur shfaqen dëshmitarë të mbrojtur, nuk mundësojnë hapësirë për të verifikuar nëse po realizohet parimi i gjykimit të drejtë dhe fer.

Në veçanti, nuk e konsiderojmë të justifikuar përjashtimin e publikut profesional, i cili do të monitoronte mënyrën e veçantë të dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur, në mënyrë që të vër-

tetohet zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë mënyrën e mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimin e saj në parimin e gjykimit të drejtë.

4. Gjykatat nuk i kushtojnë vëmendje të duhur rasteve të dhunës në familje

Gjatë përcjelljes së procedurave të filluara për shkak të dhunës në familje, Komiteti i Helsinkit, në njërin nga rastet, gjeti shkelje të procedurës gjatë veprimit të Gjykatës së Apelit Shkup. Gjegjësisht, për shkak të mungesës së prokurorit publik (edhe pse ishte ftuar sipas rregullave) në seancën kryesore para gjykatës së shkallës së parë, pala e dëmtuar, përkatësisht i autorizuari i tij, mori përfaqësimin e aktakuzës dhe gjykata mori vendim publik duke i shpallur të pandehurit fajtorë për „lëndim trupor“.

E pakënaqur me këtë vendim, pala e dëmtuar, përmes avokatit të vet, paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit të Shkupit, e cila vendosi ta refuzojë ankesën si të papranueshme, me arsyetimin se pala e dëmtuar në lidhje me kundërshtimin e aktvendimit, kishte të drejtë të kundërshtonte vetëm vendimin e gjykatës për shpenzimet e procedurës penale. Prokuroria Themelore Publike gjithashtu paraqiti një ankesë në lidhje me sanksionin penal, por e njehta u refuzua si i pabazuar dhe vendimi i shkallës së parë u la në fuqi.

Duke pasur parasysh që neni 455 paragrafi 7 i Ligjit për Procedurën Penale përcakton që nëse prokurori publik nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor (neni 454, paragrafi 1), pala e dëmtuar ka të drejtë si paditës të paraqesë ankesë kundër aktvendimit, pavarësisht nëse paraqet ankesë edhe Prokurori Publik, shihet qartazi se në rastin konkret, Gjykata e Apelit Shkup në mënyrë të padrejtë ka kufizuar të drejtën për të apeluar.

Komiteti i Helsinkit vërtetoi se Gjykata e Apelit Shkup shkeli dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale dhe në mënyrë të padrejtë e pengoi të drejtën për të shpjeguar pretendimet e palës së dëmtuar për sanksionin penal të përcaktuar, për shkak të mosveprimit me kujdesin e domosdoshëm në rastin konkret. Mendojmë që e njehta nuk guxon të bëhet praktikë në veprimet e gjykatave në rastet e dhunës në familje, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjeve, në mënyrë që viktimat e dhunës në familje të marrin mbrojtje ligjore efektive dhe efikase dhe të ushtrojnë të drejtat që u përkasin në përputhje me rregulloret ligjore.

II. LEGJISLACIONI

1. Ligj për regjistër të veçantë për personat e dënuar për pedofili

Ligji për regjistrin special për personat e dënuar me aktvendim të plotfuqishëm për vepra penale - abuzim seksual të të miturve dhe për pedofili², u miratua nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në janar 2012. Komiteti i Helsinkit e mirëpret hapin e shtetit për të vepruar në mënyrë parandaluese në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, por është i mendimit se publikimi i emrave dhe të dhënave të tjera personale në Regjistër, është në kundërshtim me nenet 18 dhe 25 të Kushtetutës së RM - së, të cilat qytetarëve ua garantojnë të drejtën për privatësi të të dhënave personale, jetës personale e familjare dhe mbrojtje nga lëndimi i integritetit personal që buron nga regjistrimi i informatave rreth tyre. Në praktikë, të dhënat e publikuara mund të jenë të pasakta, jo të plota ose të vjetruara. Publikimi do të thoshte zgjatje e dënimit gjyqësor, vështirësi gjatë punësimit ose strehimit për të dënuarin i cili e ka vuajtur dënimin, rrezik për sulm të mundshëm ndaj të dënuarve nga palë të treta, si dhe hapje të shtegut të mundshëm për rrjetëzim ndërmjet kriminelëve seksualë. Përveç këtyre shkeljeve të të drejtave kushtetuese të të dënuarve dhe rreziqeve shoqërore, nuk mund të lihet anash as ndikimi i të dhënave të publikuara mbi dinjitetin, nderin dhe reputacionin e familjeve të tyre, veçanërisht në mjedisin në të cilin ato jetojnë dhe punojnë. Në vend që të përdorë metodë antikushtetuese, me qëllim të parandalimit, shteti duhet të zbatojë metodat që i ofron mjekësia moderne, siç janë terapia anti-hormonale (kasttrim kimik ose tredhje) dhe psikoterapia. Për zbatimin e suksesshëm të këtyre metodave, është e nevojshme që në programet për risocializimin dhe përshtatjen sociale për personat e dënuar që vuajnë dënimin me burg, të parashihet trajtim i veçantë për autorët e veprave penale në lidhje me abuzimin seksual dhe pedofilinë.

2. Ligji për Përgjimin e Komunikimeve

Ndryshimet e fundit në Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve³ u miratuan në shtator të vitit 2012. Komiteti i Helsinkit, tani më disa vite me rradhë, ndjek me interes të veçantë ndryshimet në këtë ligj, i cili mund të ketë pasoja të mëdha negative për liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve.

Në vitin 2010, Komiteti përgatiti një analizë të veçantë lidhur me dispozitat dhe zbatimin e ligjit, në të cilën vuri në dukje se ligji përmban shumë jokonsekuenca dhe rreziqe për shkelje të të drejtave themelore⁴. Përkundër sugjerimeve të dhëna, në shtator 2012 u miratuan ndryshime edhe më ndërhyrëse, të cilat parashikojnë që, në vend që vetëm Ministri i Brendshëm, propozim për përgjim mund të japë cildo nëpunës policor. Paraprakisht, ligji parashihte që përgjimi mund të zgjaste më së shumti deri në 30 ditë, kurse sipas ndryshimeve, ky afat zgjatet në 4 muaj, por ekziston mundësia për zgjatje shtesë deri në 14 muaj. Ndërsa paraprakisht

2 „Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 11/2012

3 „Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.121/2006; 110/2008 dhe 116/2012

4 „Privatësia nën vëzhgim: Analizë e shkurtër për propozim ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për komunikimet elektronike“. Mund ta gjeni në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/38#>

ishite e paraparë që përgjimi legal të mund të zgjaste vetëm një kohë të caktuar, e cila është e nevojshme për mbledhjen e të dhënave për të arritur qëllimet e ndjekjes, kjo dispozitë në ligjin e ri është fshirë. Kjo në praktikë do të thotë që secili, për të cilin është dhënë urdhër që të ndiqet, do të jetë nën përgjim të vazhdueshëm katër mujor, madje edhe përskaj asaj që gjatë ndjekjes ai nuk është autor i veprave penale.

3. Ligji për Policinë

Ndryshimet e fundit në Ligjin për Policinë⁵ u miratuan në nëntor të vitit 2012. Pa kurrfarë diskutim ekspertësh, në një mënyrë jashtëzakonisht jotransparente dhe në valën e pushimeve verore, Ministria e Punëve të Brendshme propozoi ndryshimet të cilat më vonë u miratuan plotësisht. Ligji parashikon vendosjen e „kontrollit të zgjeruar operativ” të personave dhe pajisjeve, pa përcaktuar se për çfarë lloj kontrolli bëhet fjalë. Nuk janë përcaktuar metodat e kontrollit, kështu që ekziston rreziku që qytetarët t’i nënshtrohen mbikëqyrjes së fshehtë audio, video dhe elektronike, kurse kohëzgjatja e kontrollit varet nga vendimi i policisë dhe jo i gjykatës. Është paraparë „Veprim i fshehtë policor”, mbledhje e informatave nga qytetarët (informatorët) si „burime të fshehta të informatave” dhe „mbikëqyrje e fshehtë e intensifikuar dhe mbikëqyrje operative në vendet publike”. Nuk është dhënë përkufizim për asnjë prej këtyre termave. Është veçanërisht e paqartë nëse mbikëqyrja e fshehtë e përforcuar nënkupton vetëm një vëzhgim vizual të personit të caktuar, apo përfshin edhe mbikëqyrje video, përkatësisht elektronike. Nuk është përcaktuar as periudha maksimale e lejuar gjatë së cilës mund të vëzhgohet personi. Këto masa mund të çojnë në sjellje arbitrare dhe të paligjshme të policisë. Të gjitha këto mund të rezultojnë në shkelje serioze të integritetit personal, mosrespektim të privatësisë, jetës personale dhe familjare, si dhe të dinjitetit dhe reputacionit të qytetarëve. Janë paraparë 50 lloje të evidentimit që duhet t’i mbajë policia dhe të cilat do të mbahen përgjatë afatit kohor prej 2 vjet deri në përgjithmonë. Nëse ndonjë qytetar kalon rrugën jashta rregullave dhe për këtë thirret në gjykatë, policia do të mbajë emrin dhe të dhënat e tij 5 vjet. Përgjatë të njëjtës periudhë qytetari do të jetë në listën e policisë nëse ka bërë ankesë kundër policit. Për pjesëmarrje në një aksident trafiku, të dhënat do të ruhen 10 vjet. Për qytetarët që kryejnë vepra penale, pavarësisht nga masa e dënimit, policia do të dijë derisa të jenë gjallë. Komiteti i Helsinkit paraqiti komentet dhe vërejtjet e veta konkrete në Parlamentin e RM - së, por ato nuk u shqyrtuan gjatë miratimit të ligjit.

5 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.114/2006; 6/2009 dhe 145/2012

4. Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve

Gjatë operacionit policor „Monstra”, u hap edhe një tjetër çështje shumë e rëndësishme, e që ka të bëjë me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve⁶. Pas arrestimit të Haki Azirit, kishte filluar procedura për përfshirjen e tij në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Pas arrestimit, ai u ndalua për gjashtë ditë në një vend të panjohur. Para se t’i përcaktohej statusi i dëshmitarit të mbrojtur, pasi që shprehu pakënaqësi para gjykatësit hetues, Haki Aziri nga dëshmitar i mundshëm, fitoi statusin e një të dyshuari. Rasti lë hapësirë për shqetësime serioze se ekziston një mundësi reale që ligji, „në përputhje me nevojat e procedurës”, të mund të keqpërdoret, veçanërisht në procedurën parahetimore. Gjegjësisht, ligji përcakton që dëshmitar i mbrojtur mund të jetë një person i cili do të paraqitet vullnetarisht për këtë, kurse për vendimin e tij nuk është e domosdoshme të njohtohet as avokati i tij dhe as anëtar i familjes së tij. Pikërisht kjo mundësi lë hapësirë që nën kërcënime policore, një person i caktuar, nën presion, të nënshkruajë pëlqim për kyçje në programin për mbrojtje të dëshmitarëve. Megjithëse propozimin për përfshirje në program e paraqet Prokurori Publik, kurse për kyçjen vendos Këshilli për mbrojtjen e dëshmitarëve (i përbërë nga përfaqësues të organeve gjyqësore dhe Ministrive të Drejtësisë dhe për Punë të Brendshme), asnjëri nga këta persona nuk bie në kontakt me dëshmitarin, por mufaton vetëm kërkesa e tij me shkrim të cilën e siguron MPB - ja. Komiteti i Helsinkit konsideron se në interesin e dëshmitarëve të mbrojtur është që para se të nënshkruajnë pëlqimin me shkrim për përfshirje në program, t’u jepet mundësia të konsultohen me avokat, dhe nëse në procedurë personi nuk pajtohet, gjatë kontrollit të deklaratës me shkrim, personi të dëgjohet nga prokurori publik ose nga Këshilli për mbrojtjen e dëshmitarëve.

5. Ligji për punësim dhe sigurim në rast papunësie

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2012 vuri në dukje antikushtetutshmërinë e ndryshimeve të propozuara në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, të cilat megjithatë u votuan nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 20. 06.2012. Theksuam se me ndryshimet e reja të këtij ligji rrezikohet e drejta e zgjedhjes gjatë punësimit, e cila është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe e cila nuk mund t’u merret qytetarëve.

Këto dispozita jo vetëm që rrezikojnë në mënyrë direkte të drejtën e zgjedhjes gjatë punësimit, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, por duke ia imponuar një personi të caktuar të punojë nën nivelin e arsimit ose aftësive të fituara, në mënyrë që të mos e fshijnë si të papunë në Agjenci, gjithashtu shkelin edhe integritetin moral të njeriut, i cili sipas nenit 11 të Kushtetutës është i paprekshëm, si dhe ndalimin e punës së detyruar, të parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës.

6 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr.38/2005 dhe 58/2005

Dispozitat e ligjit që ndryshojnë mënyrën e gjertanishme të mbajtjes së evidencës së personave të papunë, janë në kundërshtim me të drejtat e përmendura themelore të njeriut dhe sigurisht në kundërshtim me qëllimin që duhet të arrihet - përmirësimi i evidencës së personave të papunë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve ndaj personave të papunë të cilët në mënyrë aktive kërkojnë punë. Për të gjitha këto, dispozitat për ndryshime mund të cilësohen si një përpjekje e pasuksesshme dhe perfide, që në mënyrë kozmetike të fshihet shkalla e lartë e papunësisë në Republikën e Maqedonisë, por gjithashtu paraqesin dëshmi për numrin e madh të njerëzve me arsim sipëror, për të cilët shteti nuk ka as plan, as kapacitet për punësim.

III. VEPRIMET POLICORE

1. Vrasje e dyfishtë në Gostivar

Në fund të muajit shkurt 2012, një vrasje e dyfishtë u krye në Gostivar, nga një nëpunës policor në detyrë. E humbën jetën dy djem të moshës 26 dhe 30 vjeçare, kurse shkak për ngjarjen e pakëndshme, u tha se ishte zënka për vendparkim. Vrasja u krye me pistoletën e shërbimit të policit dhe kjo ndodhi para vajzës së tij të mitur. I dyshuari është pjesëtar i komunitetit maqedonas, ndërsa personat e vrarë ishin pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Maqedoni. Menjëherë pas ngjarjes, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) njoftoi se i dyshuari përdori armën në vetëmbrojtje, pasi që u sulmua fizikisht nga katër persona. Duke përcjellë zhvillimin e mëtejshëm të çështjes, Komiteti arriti në përfundimin se në këtë rast MPB-ja provokoi reagime në opinion, të cilat çuan në organizimin e protestave civile në Gostivar dhe Shkup, të cilat ishin një lloj vazhdimi i protestave të vitit 2011 kundër brutalitetit të policisë. Kjo ngjarje fatkeqe ngriti edhe një herë çështjen e efektivitetit të trajnimit të MPB-së në lidhje me profesionalizmin e nëpunësve të policisë, përkatësisht qëndrimin e tyre ndaj zgjidhjes së situatave të konfliktit dhe mbajtjes së armëve të shërbimit në vendet publike. Gjyqi lidhur me këtë rast duhej të fillonte në shtator 2012, por MPB - ja dy herë refuzoi të asistojë në transportimin nga qendra e paraburgimit deri në gjykatën në Gostivar, me pretekstin se „nuk është i sigurtë“. Komiteti i Helsinkit konsideron se mosrespektimi i vendimeve gjyqësore, duke dhënë shpjegime të palogjikshme, jo vetëm që është i paligjshëm, por edhe dëmton parimin kushtetues të ndarjes së pushtetit. Me vendim të shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Gostivar të vitit 2013, i pandehuri u dënua me burgim të përjetshëm.

2. Aksioni policor „Monstra“

Mënyra në të cilën u krye hetimi policor për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smillkovës në Shkup, në maj të vitit 2012, përsëri i vuri në vëmendje diskutimet mbi metodat e luftës së pakompromis të policisë kundër krimit në vend. Gjegjësisht, menjëherë pas aksionit policor, Ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankulovska deklaroi se MPB-ja i zbuloi autorët e vrasjes. E drejta e garantuar kushtetuese për prezumimin e pafajësisë, parasheh që personat e akuzuar për një vepër penale do të konsiderohen të pafajshëm derisa të provohet fajësia e tyre me vendim të formës së prerë të gjykatës. Për më tepër, menjëherë pas aksionit policor, video dhe foto të bëra nga MPB-ja u shfaqën në shumë media. Këto materiale u botuan pa i kushtuar vëmendje mbrojtjes së identitetit të personave të arrestuar, kurse edhe vetë emërtimi i aksionit policor „Monstra“ është një lloj shkelje e të drejtës për prezumimin e pafajësisë. Komitetit të Helsinkit iu drejtuan familjet e pesë (prej gjithsej gjashtë) të akuzuarve të drejtpërdrejtë për vrasjen, të cilët janë në paraburgim ose në arrati. Disa nga këta persona u mbajtën në stacion policor, kurse tre personave iu caktua edhe paraburgim afatshkurtër prej 48 orësh. Sipas rrëfimeve të tyre, u ishte mohuar e drejta për avokat, e drejta e heshtjes si dhe e drejta e përdorimit të gjuhës dhe alfabetit amtari (shqip). Personat gjithashtu u ankuan se kanë qenë të frikësuar, se një person i maskuar kishte kryer marrjen në pyetje dhe se u janë dhënë informata të rrejshme për vdekje të anëtarëve të familjeve të tyre. Disa nga të

arrestuarit gjithashtu deklaruan se kishin pësuar ofendime lidhur me përkatësinë fetare e ritet fetare dhe se kanë marrë kërcënime për integritetin e tyre fizik dhe moral. Komiteti i Helsinkit i dërgoi ankesë Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale, prej nga morri përgjigje se procedura policore ishte kryer në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.

IV. LUSTRIMI

Procesi i lustracionit, edhe gjatë vitit 2012 vazhdoi të zhvillohet jashtë kornizës së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por gjithashtu në kundërshtim me mendimin e Komisionit të Veneçias, i cili thekson qartë të gjitha jokonsekuencat në ligj, të cilat i vuri në dukje edhe Komiteti i Helsinkit dhe në të cilin e bazoi Nismën e vet për shqyrtimin e Kushtetutshmërisë së Ligjit për kusht shtesë për ushtrimin e funksionit publik, që iu paraqit Gjykatës Kushtetuese në shtator 2012.

Gjegjësisht, gjatë vitit 2011 deputetët i votuan ndryshimet e Ligjit për përcaktimin e kushtit shtesë për ushtrimin e funksionit publik (Ligji për Lustrim)⁷ drejtpërdrejt në kundërshtim me Vendimin e shfuqizuar më parë të Gjykatës Kushtetuese nga 2010, i cili vërtetoi se: lustrimi pas vitit 1991 vë në pyetje rendin kushtetues demokratik ekzistues të Republikës së Maqedonisë dhe se lustrimi i organizatave joqeveritare, universiteteve, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, etj., është ndërhyrje e shtetit në sferën ku nuk ka kompetenca të përcaktuara me Kushtetutë.

Për më tepër, me këto ndryshime ligjore parashihet detyrimi që Universitetet, organizatat joqeveritare, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, bashkësitë fetare dhe organizatat tjera, në kushtet për punësim të inkorporojnë rezultatet e lustrimit, për çka u parapa edhe ndëshkimi - humbje e vendit të punës, nëse nuk verifikohet deklarata për mosbashkëpunim. Kjo është në kundërshtim me parimin juridik se nuk mund të ketë ndëshkim për një vepër që në Kodin Penal nuk parashikohet si vepër penale.

Më 28 mars 2012 Gjykata Kushtetuese morri Vendimin më të ri⁸, me të cilin përsëri verifikoi kundërshtim të Kushtetutës në 12 nene të Ligjit të ri për Lustrimin, ndër të cilët (që është precedent juridik i antikushtetutshmërisë në Maqedoni) përsëri për të njejtat dispozita që i kishte shfuqizuar më parë.

Por, në korrik 2012, filloi zbatimi i Ligjit të ri për përcaktimin e kushtit për kufizimin në ushtrimin e funksionit publik, qasjen në dokumente dhe publikimin e bashkëpunimit me organet e sigurimit të shtetit⁹.

Sipas Ligjit, është paraparë që lustrimi të zhvillohet edhe pas vitit 1991, gjegjësisht pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale të RM - së dhe deri në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për qasje të lirë në informata të karakterit publik, pra deri më 1 shtator 2006. Kjo edhe përkundër faktit se me dy vendime të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese të RM - së u vërtetua se zhvillimi i procesit të lustrimit, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale, nuk ka asnjë justifikim kushtetues.

Kjo do të thoshte mohim të vlerave dhe institucioneve të vendosura pas miratimit të Kushtetutës. Përndryshe, një proces i tillë do të paraqitej si një alternativë bashkëkohore ndaj sistemit

7 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr.14/2008; 64/2009 dhe 24/2011

8 V. nr.52/2011 dhe V. nr.76/2011 („Gazeta zyrtare e RM-së” nr.48/2012)

9 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr.86/2012

ekzistues juridik dhe institucioneve të ndërtuara, me çka humbet dimensionin historik dhe justifikimi i Ligjit.

Ligji i ri parasheh që Komisioni për Verifikimin e Fakteve pasi të ketë kontrolluar personat, të cilëve u dedikohet Ligji, për të njejtin të mbajë një Regjistër dhe emrat e tyre dhe dokumentet që janë përdorur si prova për verifikimin e bashkëpunimit të personit me organet e sigurimit të shtetit, t'i publikojë në faqen e vet të internetit.

Publikimi i vendimit, emrave dhe dokumenteve bëhet me automatizëm, pa pritur një vendim të mundshëm të gjykatës. Një nga vendimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese të RM-së përcaktoi se publikimi i emrave është shkelje e dinjitetit, integritetit moral dhe personal të qytetarit. Në të njëjtin vendim thuhet se shpallja publike e emrave të personave do të thotë njollosje e paverifikuar dhe publike dhe se e ka karakterin e një sanksioni, i cili mund të ketë pasoja në të gjitha sferat e jetës së tyre, dhe jo vetëm ndalimin e kryerjes së funksioneve publike, që është qëllimi i Ligjit.

Dispozitat e konceptuara në këtë mënyrë, janë në kundërshtim me nenin 8 (sundimi i të drejtës dhe ndarjes së pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor), nenin 9 (barazia e qytetarëve para Kushtetutës), amendamentin XXI (mbrojtja juridike kundër akteve individuale juridike), nenin 18 (siguri dhe besueshmëri e të dhënave personale dhe mbrojtje nga cënimi i integritetit personal), nenin 25 (respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës personale dhe familjare, dinjitetit dhe reputacionit), nenin 50 (mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve individuale të administratës shtetërore) dhe nenin 51 (kufizimi i lirive dhe të drejtave të qytetarit vetëm në kushtet e parapara në Kushtetutë) të Kushtetutës së RM - së.

Gjegjësisht, sundimi i të drejtës dhe ndarja e pushtetit në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, parashikon që të gjitha aktet juridike të dalin nga bartësi i pushtetit, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës. Askush nuk mund dhe nuk guxon të kufizojë në mënyrë arbitrare të drejtat e qytetarëve, pa përmbushur kushtet e parashikuara me Kushtetutë. Në rastin në fjalë, kjo do të thotë se Parlamenti i RM - së, si bartës i pushtetit legjislativ, nuk ka kompetencë të kufizojë të drejtat ose mbrojtjen e të njejtave, përmes një organi ekzekutiv, siç është Komisioni, pa siguruar gjatë kësaj, mbrojtje juridike nga ana e gjykatës kompetente, si bartëse e pushtetit gjyqësor. Mungesa e mbrojtjes juridike nga aktet ligjore individuale rrënon sundimin e të drejtës dhe kontribuon jo vetëm për pabarazi midis qytetarëve, por edhe për ndërhyrje arbitrare të shtetit në mënyrën se si qytetarët realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre.

Komiteti i Helsinkit, përmes një Iniciative për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit, e kontestoi këtë Ligj para Gjykatës Kushtetuese, duke propozuar edhe marrjen e vendimit për ndalimin e kryerjes së veprimeve që ndërmerren në bazë të Ligjit, në mënyrë që qytetarët t'u shmangen pasojave që vështirë mund të shmangen.

Ndërkohë, Komisioni për Verifikimin e Fakteve vazhdoi në faqen e vet të internetit të publikojë emrat e bashkëpunëtorëve të pretenduar me organet e sigurimit të shtetit, përpara se statusi i tillë t'u konfirmohet nga Gjykata Administrative, e cila anuloi dy vendime të marra nga Komisioni.

Më 17 dhjetor 2012, Komisioni i Venecias pranë Këshillit të Evropës shpalli mendimin e vet të parë juridik (amicus curiae) mbi Ligjin e Lustrimit. Në Dokument thuhet se mendimi juridik është përgatitur me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të RM - së, drejtuar Komisionit të Venecias më 7 shtator 2012, përkatësisht katër ditë pas Nismës së dorëzuar nga Komiteti i Helsinkit. Gjatë analizës së mendimit juridik, Komiteti i Helsinkit vërtetoi se Komisioni i Venecias ka shqyrtuar të gjitha dispozitat, të kontestuara nga ana e Komitetit. Mendimi është konceptuar në katër pjesë kryesore që kanë të bëjnë me: 1) hapësirën kohore për të cilën zbatohet Ligji, 2) subjektet që ai i përfshin, 3) garancitë procedurale të personave për të cilat zhvillohet procedurë dhe 4) publikimin e emrave të tyre në internet. Konkluzionet kryesore që dalin nga dokumenti (bazuar në standardet ndërkombëtare, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe studimin krahasues të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore në vendet e tjera evropiane që zbatojnë ose e kanë zbatuar procesin e lustrimit) janë:

1) Njëpërmjet të inkorporimit të masave të lustrimit, pas një periudhe më të gjatë nga fillimi i proceseve demokratike në një vend, ekziston rreziku i ngritjes së dyshimeve për qëllimet e vërteta të masave të tilla. Hakmarrja nuk guxon të mbizotërojë mbi mbrojtjen e demokracisë.

2) Praktika (praktikimi) e masave të lustrimit për subjektet që mbajnë pozita në ndërmarrje private ose në pronësi të përbashkët, tejkalon qëllimin e lustrimit.

3) Mungesa e personit kundër të cilit zhvillohet procedura e lustrimit gjatë procedurës para Komisionit për Verifikimin e Fakteve, nuk është në pajtim me të drejtat e tij të mbrojtjes, e posaçërisht me të drejtën e "barazisë së armëve".

4) Emri i personit që konsiderohet bashkëpunëtor duhet të publikohet vetëm pas vendimit përfundimtar të gjykatës.

Konkluzionet e këtilla janë vetëm konfirmim i argumentimit që e përdori Komiteti i Helsinkit në hartimin e Nismës me të cilën e kontestoi Ligjin për Lustrim para Gjykatës Kushtetuese të RM - së.

V. DISKRIMINIMI

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut monitoroi në mënyrë aktive situatën me diskriminim në Republikën e Maqedonisë gjatë gjithë vitit 2012 dhe konstatoi se përkundër faktit që kanë kaluar 2 vjet nga zbatimi i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, ende nuk mund të flitet për mbrojtje efektive në fushën e diskriminimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për grupe të marginalizuara. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi mbeti i pandryshuar, pavarësisht kritikave nga opinioni profesional dhe sektori joqeveritar, veçanërisht për pjesët që lejojnë punonjësit në administratën shtetërore të jenë anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por edhe për mospërfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza për mbrojtje nga diskriminimi. Intensiteti i punës së Komisionit dhe dukshmëria e tij në opinion nuk u rrit as në vitin 2012, gjë që i la edhe më tej qytetarët të painformuar për mundësitë e mbrojtjes në rast të diskriminimit dhe për kompetencat e Komisionit për mbrojtjen e tyre. Fakti që në vitin 2012 ende nuk kishte asnjë çështje gjyqësore për vërtetim të diskriminimit, flet për vetëdijen e qytetarëve për mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi.

2. Trendet dhe grupet e prekshme

Duke vepruar në bazë të ankesave të paraqitura nga qytetarët dhe duke monitoruar situatën në shoqëri dhe në media, konstatoam se në vitin 2012, më të ekspozuar ndaj diskriminimit ishin personat LGBTI, për të cilët ekziston edhe diskriminim sistemor, për shkak të mospërfshirjes së orientimit seksual dhe identitetit gjinor në një numër të madh të ligjeve, me të cilat do të sigurohej mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe përfshirje e tyre në shoqëri.

Komiteti i Helsinkit nuk konstatoi kurrfarë përparimi në mbrojtjen nga diskriminimi, as në ngritjen e vetëdijes për diskriminimin shoqëror kur bëhet fjalë për romët, të cilët mbeten një nga komunitetet më të prekshme në shoqërinë tonë. Pavarësisht vërejtjeve të shumta të Komitetit ndaj diskriminimit të komunitetit Rom, veçanërisht kur bëhet fjalë për arsimin dhe veçimin e fëmijëve Romë, deri më tani shteti nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për të zgjidhur këtë problem.

Diskriminimi i fëmijëve romë dhe veçimi i tyre sistematik, për shkak të mungesës së mekanizmave dhe praktikave të vendosura për vlerësimin e fëmijëve, zhvillimit të tyre psikologjik dhe fizik, si dhe mungesa e arsimit dhe informimit midis prindërve të komunitetit rom, vënë në dukje nevojën për të inspektuar shkollat dhe marrjen e masave të duhura për të ndryshuar praktikën aktuale. E drejta për arsimim dhe qasje të barabartë në arsim, është e drejtë e secilit fëmijë, pavarësisht nga përkatësia e tij etnike. Në këtë drejtim edhe zhvillimi i fëmijëve duhet të jetë prioritet i të gjitha institucioneve përkatëse në Republikën e Maqedonisë.

Barazia gjinore u vu përsëri në pikëpyetje në vitin 2012, veçanërisht për shkak të prezentimit të grave, nga përfaqësuesit e qeverisë dhe kishës, vetëm në rolin e nënës dhe bashkëshortes, me çka vazhdimisht vihet në pyetje barazia e grave në shoqëri dhe përfshirja e tyre e plotë shoqërore.

Punësimi në bazë të përkatësisë politike në administratën shtetërore dhe publike, mbetet një nga problemet më të mëdha me të cilat shteti refuzon të merret. Në vitin 2012, ishte i qartë vazhdimi i trendit të punësimeve politike dhe diskriminimit mbi baza politike në marrëdhëniet e punës në administratën shtetërore dhe publike, me çka një numri të madh të qytetarëve iu kufizua e drejta për punë, për shkak të mospërcaktimit politik ose përcaktimit politik të ndryshëm nga partitë në pushtet.

VI. LIRIA E SHPREHJES DHE LIRIA E MEDIUMEVE

Gjatë vitit 2012, Komiteti i Helsinkit në disa raste shprehu shqetësim për situatën në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, të cilat janë kategori të garantuara me kushtetutë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kontekst, mediumet, gazetarët dhe e drejta për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medimeve, ishte çështje monitorimi dhe interesi të vazhdueshëm edhe të organizatave ndërkombëtare.

Gjegjësisht, kur bëhet fjalë për këtë të drejtë, "Freedom House" i shquar, konstatoi rënie drastike të Republikës së Maqedonisë prej 20 vendeve krahasuar me vitin e kaluar, kështu që aktualisht Republika e Maqedonisë ndan vendin e 115-116 me Moldavinë.

Vërejtjet e organizatave ndërkombëtare, të cilat janë pothuajse identike me ato të Komitetit të Helsinkit, janë se liria e mediave përgjithësisht ndotet nga ndikimi i partive politike në politikën editoriale, që është më se e dukshme, si dhe duke injoruar rekomandimet e dhëna në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2011¹⁰.

1. Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje - hyrje në censurë?

Në fund të vitit 2012, u miratua Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, i cili dekriminalizoi fyerjen dhe shpifjen. Me miratimin e këtij ligji, gazetarët i nënshtrohen një goditjeje, kur merret parasysh ballafaqimi i tyre me fenomenin e vetëcensurës, si dhe gjobat e larta të parapara për autorët e fyerjes ose shpifjes, përfshirë edhe presionin politik që në pjesën më të madhe u bëhet gjykatave.

Në fazën e miratimit të ligjit, Komiteti i Helsinkit dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile vunë në dukje se ligji i propozuar paraqet hyrje në censurë, kurse Komiteti vuri në spikamë mundësinë e humbur që Ligji të miratohet në një debat më të gjerë publik dhe në konsultim me organizatat e shoqërisë civile, gjë që sigurisht do të kontribuonte Ligji të fitojë besueshmëri më të madhe në opinion dhe t'i largojë dyshimet se i gjithë procesi i miratimit të ligjit është rezultat i interesave ditore politike.

Për shkak të jokonsekuencave në ligj që ndikojnë drejtpërsëdrejti në të drejtën e lirisë së shprehjes së individëve, pas miratimit të tij, Komiteti i Helsinkit në bashkëpunim me një grup të shoqatave të tjera civile, paraqiti një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje.

10 Teksti punues i shërbimeve të Komisionit, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raport për progresin-Bruksel, 12.10.2011 Sec(2011) 1203 verzioni përfundimtar
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf

Gjithashtu, Komiteti i Helsinkit e konsideron të duhur të theksojë se në kohën e shkrimit të këtij raporti, në fazë të miratimit është një Ligj i ri për Mediumet dhe Shërbimet e Mediave Audiovizive, me ç'rast Komiteti dëshiron të theksojë se me këtë ligj do të ndalohet zhvillimi i mediave dhe liria e shprehjes dhe liria e medias do të kufizohet edhe më shumë.

2. Gjuha e urrejtjes

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, sikur viteve të kaluara, ashtu edhe këtë vit, ka deklaruar vazhdimisht se gjuha e urrejtjes është gjithnjë e më e pranishme në jetën tonë të përditshme, duke shkaktuar dëme të pariparueshme në jetën tonë shoqërore, me ç'rast nuk u përjashtua trendi i përshkallëzimit të gjuhës së urrejtjes. Në këtë drejtim, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, vazhdimisht monitoroi mediat, rrjetet sociale dhe deklaratat e bartësve të funksioneve të larta publike dhe përfaqësuesve të partive politike dhe njëherit konstatoi se gjatë vitit 2012, gjuha e urrejtjes shënon rritje, që rezulton edhe me dhunë fizike që po bëhet pjesë e jetës së përditshme në Republikën e Maqedonisë.

Duke përcjellë ngjarjet që shënuan këtë vit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut identifikoi një numër të caktuar ngjarjesh që vepruan si një marrëdhënie shkak-pasojë, ku gjuha e urrejtjes rezultoi me gjuhë të re të urrejtjes. Për më tepër, shqetësues është fakti që gjuha e urrejtjes shpesh nxit edhe krime të urrejtjes¹¹. Si rezultat i kësaj, mbetet përshtypja se në vitet e fundit deri më sot, qytetarët kanë qenë dëm kolateral i grupeve shoqërore që qëllimisht nxisin urrejtje ndërmjet njerëzve për të arritur qëllimet e veta, ndërsa interesi shoqëror ose shtetëror është vënë mënjanë.

Është me interes të veçantë të theksohet se në Republikën e Maqedonisë përkufizimi i gjuhës së urrejtjes dhe kriminalizimi i tij problematizohet, por gjithashtu manipulohet, me ç'rast thuhet se sanksionimi i fjalës automatikisht nënkupton kufizimin e lirisë së shprehjes. Nën këtë pretekst, tani më një kohë të gjatë jemi dëshmitarë etiketimesh, fushatash negative kundër figurave të caktuara publike, shpifjeve, homofobisë, transfobisë, mizogjinisë së shprehur dhe nxitjes së urrejtjes etnike dhe politike.

11 U dogj flamuri maqedonas

<http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=6&item=13949>;

U dogjën disa kisha në Strugë dhe rrethinë <http://dnevnik.mk/default.asp?ItemID=ED90E54492C-0454BAA6F47E00FD65AB0>

Përleshje fizike masive disaditëshe ndërmjet të rinjve në autobusët e NTP dhe në Maqedoninë perëndimore <http://www.telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1..&rub=6&item=20572> и <http://daily.mk/cluster/6c-9cf9c632ce7f6b8c89284bb3155898>

VII. INSTITUCIONET E MBYLLURA

1. Torturë ndaj të paraburgosurve në burgun hetimor të Shkupit

Gjatë muajit tetor 2012, një grup personash anonimë paraqitën një ankesë dhe fotografi në Komitetin e Helsinkit, dhe në ankesë shpjeguan se punonjësit e njësive së paraburgimit në burgun e Shkupit torturuan tre të paraburgosur, që ishin shtetas shqiptarë, dhe i lanë për rreth tri orë të lidhur me pranga për radiatorë. Ministri i Drejtësisë, Blerim Bexheti, për mediat deklaroi se ka pasur keqpërdorim të të paraburgosurve dhe se masat e duhura do të merren menjëherë, si dhe do të ngrihen kallëzime penale kundër autorëve të kësaj vepre ndëshkimore. Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve për mediumet deklaroi se do të ngrihen kallëzime penale edhe kundër personave të panjohur që fotografuan dhe dokumentuan ngjarjen në mënyrë të paligjshme. Komiteti i Helsinkit konsideron se ngritja e kallëzimeve penale ka për qëllim frikësimin e personave zyrtarë në institucione të mbyllura dhe mos raportimin e rasteve të torturës. Nga ana tjetër, mosndëshkimi i punonjësve në këto institucione, në rast se vërtetohet se kanë kryer ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut, përsëri flet për faktin se shkeljet e këtilla të të drejtave të njeriut nuk arrijnë në opinion. Në pajtim me nenin 364, paragrafin 1 të Kodit Penal, moskallëzimi i një vepre penale paraqet vepër penale në vehte. Komiteti i Helsinkit përkujton se në pajtim me nenin 142, paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, për veprat e përshkruara në ankesë, dënimi me burg është prej një deri në pesë vjet.

2. Mbrojtja shëndetësore

Gjatë vitit 2012, disa të dënuar iu drejtuan Komitetit të Helsinkit nëpërmjet të telefonit dhe me letra, duke deklaruar se kishin nevojë për ndihmë në ushtrimin e të drejtës së tyre për kujdes shëndetësor, gjë që është në pajtim me nenet 124 dhe 129, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve¹². Këta persona, për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore, me vetëiniciativë dhe me shpenzimet e veta, kërkojnë nga shërbimet e burgut të dërgohen për trajtim mjekësor jashtë burgut ku po vuajnë dënimin. Komiteti i Helsinkit në vitin 2012, konstatoi se personat kompetentë në burgje vonojnë pa nevojë procesin e mjekimit të të dënuarve dhe dërgimin e tyre për trajtim mjekësor, një situatë që dëmton shëndetin e këtyre personave, duke shkelur kështu edhe të drejtën e tyre të garantuar me ligj për mbrojtje shëndetësore.

12 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.2/2006 dhe 57/2010

3. Ndhurma juridike

Një numër i madh i personave të gjykuar të cilët kontaktuan me Komitetin e Helsinkit në vitin 2012, u ankuan për mosfunksionimin e shërbimeve juridike në institucionet ndëshkimore - rehabilituese. Disa nga të dënuarit që kërkuan ndihmë juridike falas nga Komiteti, nuk ishin aspak të informuar për mundësinë e marrjes së ndihmës juridike në vetë burgjet. Megjithëse shërbimi juridik i Komitetit të Helsinkit i këshilloi ata që për të drejtat e tyre, përmes ankesave dhe lutjeve t'u drejtohen drejtorëve të burgjeve, të dënuarit, pothuajse pa përjashtim, deklaruan se nuk i besojnë këtij sistemi dhe nëse do ta bënin këtë, vetëm që do të vështirësonin situatën, edhe ashtu të vështirë në burg. Përballë këtij mosbesimi, Komiteti i Helsinkit i udhëzoi të dënuarit të dërgojnë lutje me shkrim me kërkesë për vizitë nga përfaqësuesit e Komitetit. Shqetësim të veçantë paraqet fakti që edhe pas një rekomandimi të tillë, të cilin të dënuarit e pranuan, disa nga lutjet e tyre nuk arritën fare në zyrën e Komitetit të Helsinkit. Ky problem është veçanërisht karakteristik për INR „Idrizovë“. Prandaj, ekziston një dyshim i arsyeshëm se nëpunës të caktuar në burgje nuk veprojnë lidhur me kërkesat me shkrim të të dënuarve, dhe kështu janë edhe autorë të mundshëm të veprës penale „Shkelje e të drejtës për paraqitje të mjetit juridik“ sipas Kodit Penal të RM - së.

4. Rikonstruimi i burgjeve

Me një kredi prej 52 milion eurosh të siguruar në vitin 2009 nga Banka për rindërtim dhe zhvillim pranë Këshillit të Evropës, fondet IPA dhe Qeveria e Norvegjisë, Ministria e Drejtësisë duhej të niste projektin për rikonstruimin dhe sanimin e burgjeve në Institucionet ndëshkimore rehabilituese në të gjithë vendin. Ishte paraparë një sanim thelbësor, por edhe prishja e objekteve ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja me kapacitet më të madh. Përmes këtij projekti, premtuhej një pamje krejtësisht e re e INR „Idrizovë“, Burgut të Shkupit, Institucionit edukativo-korrigjues në Tetovë dhe përfundim i aktiviteteve ndërtimore të burgut të ri në Kumanovë. Megjithëse deri në vitin 2012 kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga sigurimi i kredive të volitshme, puna në terren nuk ka filluar fare. Ministria e Drejtësisë në një procedurë skajshmërisht burokratike dhe të ngadaltë lidhur me projektet teknike, elaboratet dhe tenderët, nuk arriti të përdorë fondet tashmë të siguruara. Megjithëse ky projekt duhej të kishte filluar më së voni në vitin 2011 dhe deri më tani të ishte në një fazë më të përparuar, deri në përfundimin e këtij raporti, ende anuloheshin tenderët dhe nuk ishte zgjedhur asnjë kontraktor i punëve ndërtimore. Kjo situatë flet për joprofesionalizmin e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të të cilit mijëra të dënuar po qëndrojnë në kushte substandarde për jetë. Ndërkohë, mbipopullimi i burgjeve po rritet, duke arritur rreth 120 përqind në vitin 2012. Me këtë mosaktivitet, Republika e Maqedonisë jo vetëm që nuk arriti t'i përmbushë rekomandimet e Komitetit për parandalimin e torturës pranë Këshillit të Evropës, por gjithashtu përkeqësoi më tej të drejtat e njeriut të personave që vuajnë dënimin me burg.

5. Institucionet psikiatrike

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2012 vizitoi institucionet e mëposhtme të llojit të mbyllur: ISHP Spitali Psikiatrik „Shkup” - Shkup në Bardovcë, ISHP Spitali Psikiatrik „Negorci”, Institutin special për personat mentalisht të retarduar - Demir Kapi, ISHP Spitali Psikiatrik - Demir Hisar dhe Institutin Publik Entin për mbrojtje dhe rehabilitim - Banja Banskovo¹³. Problemet e përgjithshme që ekzistojnë në këto institucione janë: a) numër i vogël i mjekëve specialistë, internistëve, motrave medicinale, infermiereve dhe personave për mbajtjen e higjienës, b) numër joadekuat i qendrave të kujdesit ditor për personat me sëmundje mendore (veçanërisht në lidhje me persona vartës nga alkooli, droga), c) mungesa e trajnimit profesional për stafin, ç) numër i pamjaftueshëm i ekzaminimeve parandaluese tek internisti si dhe ekzaminimeve të tjera përkatëse (p.sh. gjinekologjike, dentare, virale, etj.), d) kushtet e këqija të jetesës për shkak të periudhës së gjatë të pasivitetit në fushën e rikonstruimit ose ndërtimit të ndërtesave të reja (numër i pamjaftueshëm i shtretërve, çarçafëve, tualeteve dhe dollapëve personale për të gjithë pacientët) dhe e) mos përdorimi i terapive të përshtatshme që do të ofronin qasje të vërtetë bio- psikosociale në mjekim.

13 Shih „ Raport nga vizita e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të RM-së në Institucionet speciale dhe spitalet psikiatrike në RM për vitin 2011 dhe 2012”. Mund ta gjeni në: <http://www.mhc.org.mk/press/104#>

VIII. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

Vitin 2012 lirisht mund ta quajmë vit të luftës kundër padrejtësisë sociale dhe realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave ekonomike dhe sociale. Ky konstatim buron nga një varg protestash përmes të cilave qytetarët kërkuan që shteti të mbrojë të drejtat e tyre si: konsumatorë (iniciativa civile AMAN), punëtorë të falimentuar (Riparim i hekurudhave, OHIS dhe shoqata civile UNIT) dhe punonjës shëndetësorë (grevë e punonjësve shëndetësorë). Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjithashtu konstatoi shkelje edhe në realizimin e të drejtës për ndihmë financiare sociale, si dhe parregullësi në punën e Komisionit Rregullator.

1. Iniciativa qytetare AMAN

Nisma civile AMAN u formua si reagim ndaj vendimeve të Komisionit Rregullator të Energjisë në lidhje me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike, përkatësisht heqjes së tarifës së lirë ditore të energjisë elektrike dhe ndaj ndryshimeve në Rregullat për furnizimin me energji për ngrohje, me të cilat u përcaktua detyrimi që qytetarët që janë shkëputur nga sistemet e furnizimit me ngrohje, megjithatë duhet t'ia paguajnë një shumë të caktuar parash, furnizuesit me energji për ngrohje. Qytetarët protestuan në disa qytete në Republikën e Maqedonisë kundër vendimeve të tilla të Komisionit Rregullator, duke kërkuar që shteti të mbrojë të drejtat e tyre si konsumatorë dhe të mos rrezikojë më tej standardin edhe ashtu të ulët të jetesës. Përveç shprehjes së pakënaqësisë së tyre përmes protestave, iniciativa civile AMAN, me mbështetjen e 13,000 qytetarëve, arriti të paraqesë propozimligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Energjinë.

Me ndryshimet e propozuara kërkohej që në sistemet tarifore për shitjen e energjisë elektrike familjeve si konsumatorë tariforë dhe familjeve që furnizohen përmes furnizuesve si një mundësi e fundit, Komisioni Rregullator i Energjisë detyrimisht të përfshijë çmime të ngarkesave të ulëta ditore në kohëzgjatje prej 3 orësh gjatë ditës, në periudhën nga ora 10 e mëngjesit deri në orën 18 dhe të dielën, si dhe konsumatorët e shkyçur të energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gaz natyror të mos jenë të detyruar të paguajnë kurrfarë kompensimi. Propozimligji nuk u mbështet nga shumica e deputetëve të partisë në pushtet qysh në fillim të debatit në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë dhe për këtë arsye u vendos që të mos ketë një lexim të dytë mbi ndryshimet e propozuara. Përkundër këtij vendimi të Kuvendit, iniciativa civile AMAN është shembulli i vetëm i suksesshëm i praktikimit të së drejtës për demokraci të drejtpërdrejtë dhe propozimit të ndryshimeve ligjore në Kuvend, drejtpërsëdrejti nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, duke vepruar në lidhje me kërkesën e paraqitur për ndihmë juridike falas nga aktivistët e iniciativës civile AMAN dhe duke monitoruar situatën me të drejtat e qytetarëve si konsumatorë, veçanërisht pasi që në këtë rast bëhej fjalë për rrezikimin e standardit të jetesës së qytetarëve, konstatoi se familjet si konsumatorë nuk janë aspak të mbrojtura nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të energjisë elektrike dhe pozi-

cionimit të monopolit të shpërndarësve të energjisë për ngrohje. Prandaj, është e nevojshme të precizohen dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave të drejtat e familjeve si konsumatorë do të mbrohen nga aktet nënligjore të Komisionit Rregullator të Energjisë, me të cilat rrezikohet ekzistenca e numrit të madh të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht të mbrohen të drejtat ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë përmes mbrojtjes nga pozita e monopolit e ndërmarrjeve në tregun e energjisë dhe mbrojtjes nga vendosja e detyrimeve për shërbime që qytetarët nuk bien dakord t'i shfrytëzojnë.

2. Komisioni Rregullator i Energjisë

Gjatë analizës së rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator, Komiteti i Helsinkit arriti në përfundimin se heqja e tarifës së lirë ditore të energjisë elektrike ishte rezultat i dy rregullave që u sollën në bazë të dispozitave joekzistuese të Ligjit të Energjisë. Për më tepër, njëmbëdhjetë rregullat shtesë Komisioni i sollti në bazë të dispozitave të Ligjit në fjalë të përcaktuara në mënyrë të gabuar . Me që sipas nesh, bëhej fjalë për gjithsej trembëdhjetë rregulla, e informuam opinionin se Komisioni po bën gabime thelbësore në punën e tij. Në të njëjtën kohë, ia dërguam analizën tonë Komisionit, duke theksuar se vendosja e rregullave të tilla është e papranueshme dhe vë në pikëpyetje legjitimitetin e tyre. I kërkua Komisionit përgjigje nëse planifikon t'i shfuqizojë, ndryshojë ose përmirësojë aktet e veta, me ç'rast paralajmëruam se në mungesë të një reagimi të përshtatshëm, të njëjtat do t'i kontestojmë përpara Gjykatës Kushtetuese.

Rreth njëzet ditë pas dorëzimit të shkresës, arriti përgjigje e Komisionit me të cilën na informuan se në dy rregullat me të cilat është ndërprerë tarifa e lirë ditore, „janë bërë gabime teknike dhe ato u dërguan për shpallje në Gazetën Zyrtare“. Së shpejti, një korigjim u shpall edhe zyrtarisht.

Për tri nga rregullat e diskutueshme, na u shpjegua metodologjia e sjelljes së tyre dhe pas kësaj konstatoam se ato me të vërtetë nuk janë kontestuese. Lidhur me rregullat tjera, të cilat i cilësuam si kontestuese, nuk morrëm përgjigjeje, që na shpie në përfundimin se Komisioni heshtazi pajtohet se ato gjithashtu janë të gabuara. Sipas gjithë kësaj, pas korigjimeve dhe shpjegimeve për disa nga rregullat, akoma mbesin tetë akte që janë të vlefshme dhe kanë mangësi. Kjo konfirmon qëndrimin tonë fillestar se Komisioni ka kryer shkelje thelbësore gjatë ushtrimit të kompetencave të veta.

3. Ndhimja financiare sociale

Komiteti i Helsinkit gjeti shkelje të së drejtës për shfrytëzimin e ndihmës financiare sociale, dhe me këtë shkelje të të drejtave ekonomike dhe sociale në rastet e personave Dobra Petkovska dhe Semedin Nebi¹⁴. Gjegjësisht, rastet e personave Dobra Petkovska dhe Semedin Nebi, hapën pyetjen nëse sigurimi shoqëror dhe drejtësia shoqërore janë vetëm parime që nuk kanë zbatim real në jetën dhe mirëqenien e personave në rrezik shoqëror.

Ajo që është interesante të përmendet në lidhje me këto dy raste, është se gjatë vendosjes për realizimin e të drejtës për ndihmë financiare sociale, përkundër situatës pothuajse të njëjtë faktike për ndërprerjen e ndihmës financiare sociale, institucionet kompetente morën dy vendime diametralisht të kundërta, përkatësisht në rastin e parë, e drejta për ndihmë financiare sociale u rivendos me një vendim të ri, ndërsa kjo nuk ndodhi në rastin e dytë, gjë që flet për mosqëndrueshmëri në zbatimin e zgjidhjeve ligjore.

Mënyra e këtillë e veprimit e institucioneve kompetente është shqetësuese sepse ka të bëjë me familje që nuk janë të siguruar financiarisht dhe të cilat nuk mund të sigurojnë mjete për ekzistencë në bazë të rregullave ose mënyrave të tjera. Duke shprehur shqetësimin e vet për mënyrën, kushtet dhe procedurën sipas së cilës qytetarët që janë grup i prekshëm në shoqëri ushtrojnë të drejtat e tyre për mbrojtje sociale, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut konsideron se ekziston një nevojë urgjente për plotësimin e Rregullores për mënyrën e realizimit dhe shfrytëzimit të së drejtës për ndihmë financiare sociale, në mënyrë që do të përcaktojë me saktësi një shumë të caktuar të të ardhurave të realizuara që nuk do të konsiderohen si të ardhura të familjes. Kjo sigurisht që do të ngushtonte hapësirën e institucioneve kompetente për sjellje të vendimeve të mundshme të kundërta dhe të paqëndrueshme, e njëherit do të arrihej qëllimi i mbrojtjes sociale - tejkalimi i rreziqeve themelore shoqërore ndaj të cilave është i ekspozuar qytetari gjatë jetës, zvogëlimi i varfërisë e përjashtimit social dhe do të forcohej kapaciteti për vetëmbrojtje.

14 Më gjerësisht për rastet në raportin mujor të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në muajt prill qershor 2012. http://mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/147/quarterly_mk.pdf

IX. TË DREJTAT CIVILE DHE

1. Presione politike dhe pengim i protestës paqesore të iniciativave qytetare dhe aktivistëve

Të drejtat civile dhe politike në Republikën e Maqedonisë në vitin 2012 u shprehën veçanërisht përmes ushtrimit të së drejtës për protestë paqesore (tubim publik), lirisë së bashkimit dhe lirisë së shprehjes nga disa grupe shoqërore, organizata dhe shoqata joformale të qytetarëve. Në vëmendje të veçantë të Komitetit, e që njëherit u kthye në praktikë, ishte vëzhgimi i protestave paqesore me kërkesë të individëve dhe grupeve për shkak të frikës së shprehur, mosmarrëveshjeve me nëpunësit e policisë të cilët sigurojnë të drejtën për protestë paqesore, kërcënimeve, shantazheve, kufizimeve të të drejtave, presionit në formën e kundër protestave dhe diskriminimit politik për shkak të anëtarësisë në parti politike. Në vitin 2012, Komiteti i Helsinkit ishte dëshmitar i disa ngjarjeve që flasin për ndërhyrje serioze të shtetit në ushtrimin e këtyre të drejtave nga qytetarët, duke monitoruar protestat e mëposhtme paqesore dhe protestat e dhunshme dhe tubimet publike:

- Ndal për brutalitetin policor - shoqatë joformale e qytetarëve
- Iniciativa qytetare "Aman" - shoqatë joformale e qytetarëve
- Shoqata qytetare UNIT- shoqatë e regjistruar e punëtorëve të falimentuar
- Marshi i tolerancës: „ Ndal për gruafohinë (mizogjininë), homofobinë dhe transfohinë” organizuar nga Komiteti i Helsinkit me mbështetjen e rrjetit joformal të organizatave joqeveritare – organizata të regjistruara joqeveritare dhe aktivistë për të drejtat e njeriut
- „Fronti Popullor” nga njëra anë dhe mbështetësit dhe anëtarët e opozitës nga ana tjetër - tubimi publik i mbështetësve / simpatizantëve, qytetarëve dhe anëtarëve të partive politike

Liria e bashkimit dhe shprehja e pakënaqësisë përmes formës së protestës paqesore paraqet korrelacion të të drejtave civile dhe politike që të gjithë njerëzit në Republikën e Maqedonisë i gëzojnë në mënyrë të barabartë. Këto të drejta janë jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë parlamentare, duke pasur parasysh që me zbatimin e tyre arrhet baraspeshë gjegjësisht kontrollë mbi pushtetin ekzekutiv nga ana e qytetarëve si dhe shprehje e pakënaqësisë ndaj politikës së caktuar, mënyrës së qeverisjes, etj. Komiteti konsideron se çdo pengesë ose përpjekje për të kufizuar këto të drejta përbën gjithashtu shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të drejtave civile dhe politike, si pjesë e korpusit të të drejtave dhe lirive ndërkombëtare të njeriut. Në këtë pikëpamje, Komiteti me keqardhje konstaton se në vitin 2012 u regjistruan shkelje të të drejtave të theksuara më sipër dhe përshkallëzim i protestave paqesore në protesta të dhunshme, me lëndime të lehta trupore të qytetarëve dhe

policëve. Në këtë drejtim, Komiteti gjeti shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut në secilin nga grupet e lartpërmendura të qytetarëve:

1.1. Ndal për brutalitetin policor - shkelje e të drejtës për lëvizje të lirë dhe shprehje të pakënaqësisë së një grupi qytetarësh, me rastin e shënimit të njëvjetorit nga vdekja e Martin Neshkovskit, duke kufizuar qasjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme nga policët, pa ndonjë arsye. Përveç kufizimit të paligjshëm të së drejtës për lëvizje të lirë dhe shprehjes së lirë përmes formës së protestës paqesore, Komiteti konstatoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm për keqpërdorim të detyrës nga personat zyrtarët që zbatuan urdhrin, përkatësisht kufizuan lëvizjen e qytetarëve me çka u kufizua e drejta e lëvizjes së lirë dhe rrjedhimisht e drejta për protestë paqesore, bashkim dhe liri të shprehjes.

1.2. Iniciativa Qytetare „Aman“ - sipas raporteve mujore dhe katërmujore të Komitetit, u vërtetuan disa shkelje të së drejtës për protestë paqesore, bashkim dhe liri të shprehjes, që u bënë ndaj nismës qytetare joformale „Aman“ duke pasur parasysh se kjo iniciativë joformale zgjati shtatë muaj dhe përdori disa forma të pjesëmarrjes qytetare dhe politike përmes formave të demokracisë së drejtpërdrejtë. Si pasojë, tek ky grup joformal i qytetarëve që protestuan kundër rritjes së çmimeve të energjisë dhe ndikimit të tyre në buxhetin e familjeve, u konstatuan disa shkelje:

- Rrezikimi i të drejtës për protestë paqesore: Aktivistët e iniciativës civile „Aman“ u përballën me kërcënime të drejtpërdrejta për jetën nga persona ende të paidentifikuar, edhe pse të gjitha rastet e kërcënimeve u denoncuan në stacion policor. Aktivistët i denoncuan rastet, dhanë deklarata, por asnjë nga parashtruesat nuk u procesua deri në fund. Gjegjësisht, për asnjërin nga rastet e denoncuar nuk ka filluar hetim / procedurë e as nuk janë identifikuar autorët. Gjithashtu në njërin nga protestat e këtyre aktivistëve, kërcënim i drejtpërdrejtë u bë nga një aktivist i të rinjve të një partie në pushtet në prani të policit dhe aktivistët u detyruan që rastin ta paraqesin përsëri në stacionin e policisë. Si për kërcënimet paraprake, ashtu edhe për pengimin e tubimit publik, nuk u ngritën procedura, e as që u identifikuan autorët e veprave të sipërpërmendura.

- Shkelja e të drejtës për pjesëmarrje në sjelljen e vendimeve publike përmes formave të demokracisë së drejtpërdrejtë: Më 18 tetor 2012, filluan procedurën për mbledhjen e 10,000 nënshkrimeve, në pajtim me Ligjin për Referendum dhe format e tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve¹⁵ për të bërë ndryshimet në Ligjin për Energji¹⁶, por Qeveria e Republikës së Maqedonisë e keqpërdori afatin e papërcaktuar brenda të cilit duhet të informojë organin e administratës shtetërore, përgjegjës për regjistrimin e së drejtës së votës ose në këtë rast Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përmes nenit 67, paragrafi 1 i ligjit. Megjithëse iniciativa ishte e rregullt, e miratuar nga Presidenti i Kuvendit dhe dy komisionet parlamentare brenda afateve ligjore, Qeveria nuk e njoftoi Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për të vepru-

15 „Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.81/2005

16 „Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.16/2011 dhe 136/2011

ar menjëherë për iniciativën, duke shkurtuar kështu ndjeshëm afatin 3-mujor për mbledhjen e 10,000 nënshkrimeve. Procedura filloi më 06.12.2012 dhe zgjati deri më 30.01.2013 me çka Qeveria rrezikoi drejtpërdrejt këtë të drejtë dhe kufizoi kohëzgjatjen e procedurës në një muaj, nga tre muajt e paraparë me ligj.

- Diskriminimi politik, diskreditimi dhe etiketimi: Disa nga aktivistët e kësaj iniciative u etiketuan nga disa media si aktivistë të partisë politike të opozitës, duke aluduar se si të tillë nuk janë të përshtatshëm për të shprehur pakënaqësinë e tyre si qytetarë përmes formave të protestës paqesore dhe aktivizmit qytetar. Kështu, në mënyrë të drejtpërdrejtë bëhet diskriminim politik ndaj qytetarëve, të cilët, përveç të drejtave civile kanë edhe të drejta politike, e njëherit kemi të bëjmë me papërshtatshmëri për shkak të përkatësisë politike, me çka imponohet një imazh i rremë në opinion se qytetarët që janë anëtarë të një partie nuk mund të gëzojnë të drejtat e tyre civile, siç është e drejta për të protestuar.

1.3. Shoqata Civile UNIT - më 27 shtator 2012, një grup punëtorësh të falimentuar dhe përfaqësuesja e tyre Liljana Georgieva u nisën për në protestën e paralajmëruar para Parlamentit të RM - së. Komiteti i Helsinkit doli në terren për të monitoruar protestën, për shkak se kishte informatë që qytetarët nuk mund të ushtronin paqesisht të drejtën e tyre për të protestuar dhe për tubim publik dhe se janë penguar nga disa grupe që u paraqitën në protestën e caktuar. Pasi mbërriti para Parlamentit të RM - së, Komiteti i Helsinkit u përpoq të merrte informacion nga policët në lidhje me identifikimin e dy grupeve që qëndronin përballë njëra-tjetrës, e të cilat ishin të ndara me një kordon policor. Megjithatë, një informacion i tillë nuk u mor. Punëtorët e falimentuar sqaruan se policët nuk reagueshin ndaj kërcënimeve që iu drejtuan punëtorëve, e as nuk u siguruan kushtet e duhura në mënyrë që të dy grupet të gëzonin të drejtën për të protestuar, për shkak të reagimit të papërshtatshëm të policisë. Pas mbërritjes së një përfaqësuesi të Komitetit, qytetarët ushtruan të drejtën e tyre për të protestuar.

1.4. Marshi i tolerancës: „STOP për gruafobinë (misogjininë), homofobinë dhe transfobinë” - më 17 nëntor 2012, Komiteti i Helsinkit mbajti „Marshin e tolerancës”, i cili shënoi për herë të katërt Ditën Ndërkombëtare të Tolerancës. Komiteti në mënyrë të përsëritur ka informuar publikun se nëpërmjet të mediave po zhvillohet fushatë për ngecje të statusit shoqëror të gruas përmes një sulmi të tërthortë të së drejtës për zgjedhje, imponim të fajit për rënien e natalitetit të „kombit”, propagandës homofobike dhe transfobike që pretendon drejtpërdrejt se pjesëtarët e komunitetit LGBTI nuk mund të kontribuojnë në zhvillimin e „kombit të shëndetshëm”. Si pasojë e kësaj fushate, „Marshi i tolerancës” filloi me sulm fizik ndaj dy aktivistëve për të drejtat e njeriut, gjatë përgatitjes së tendave për organizatat joqeveritare që mbështetën ngjarjen. Kjo flet për shkeljen e të drejtës së shprehjes në formën e protestës paqesore, gjegjësisht pengim të tubimit publik, me çka është bërë përpjekje për të parandaluar ose pamundësuar të drejtën e qytetarëve për të shprehur lirisht mendimin e tyre.

1.5. Protesta e “Frontit Popullor” dhe mbështetësve dhe anëtarëve të opozitës së bashkuar: tubim publik i mbështetësve / simpatizantëve, qytetarëve dhe anëtarëve të partive politike -

më 24.12.2012 përfaqësues të Komitetit dolën para Parlamentit të Republikës së Maqedonisë ku panë protesta të dy grupeve. Për një kohë të shkurtër, protestat nga paqesore u kthyen në të dhunshme, pasoi ndërhyrja e policisë për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe rrezikim të sigurisë së pjesëmarrësve në protesta. Komiteti konstatoi se në këto protesta pati përdorim të forcës së tepruar nga policët, vetëm ndaj njërit grup të pjesëmarrësve, përkatësisht ndaj anëtarëve të opozitës së bashkuar dhe qytetarëve - mbështetës / simpatizantë, kurse forcë nuk u përdor ndaj qytetarëve që përfaqësonin "Frontin Popullor". Komiteti gjithashtu konstatoi se policët nuk i ndanë grupet në një distancë të përshtatshme me kohë, kështu që protestat rezultuan edhe me lëndime të disa policëve dhe qytetarëve të cilët u transferuan për përkujdesje në spitalin e Qytetit.

2. Goditje ndaj rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë

24.12.2012

Komiteti i Helsinkit po ndjek me shqetësim zhvillimet e fundit në skenën politike maqedonase dhe me keqardhje konkludon se më 24 dhjetor 2012 në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë u godit drejtpërsëdrejti rendi kushtetues. Gjegjësisht, Komiteti përgatiti një raport¹⁷ të veçantë mbi zhvillimet në dhe para ndërtesës së Parlamentit dhe gjeti shkelje serioze të parimeve themelore të shtetit juridik dhe sundimit të të drejtës, si më poshtë:

- Nxjerrje me dhunë e gazetarëve nga Galeria e Parlamentit, të cilët në mënyrë të rregullt kishin lajmëruar praninë e tyre për të monitoruar debatin publik mbi miratimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013.

- Përdorimi i dhunës fizike ndaj deputetëve dhe deputeteve nga disa parti të opozitës, nga persona zyrtarë ende të pidentifikuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë përpjekjes për të bllokuar miratimin e Buxhetit, pas mospranimit të debatit dhe amandamenteve të propozuara nga opozita.

- Veçanërisht shqetësues është fakti që deputetët e opozitës deklaruan se ishin nxjerrë me forcë nga salla e parlamentit nga anëtarët e njësive speciale të policisë.

Në përputhje me sa më sipër, Komiteti propozoi një hetim të pavarur për ngjarjet në lidhje me 24 dhjetorin, kurse njëherit përfaqësues të lartë të Komisionit Evropian kërkuan formimin e komisionit të pavarur anketues, i cili përfundimisht me 1 Mars 2013 duhej të paraqiste faktet

17 Raportin e veçantë për mbledhjen e 49-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të mbajtur më 24.12.2012, mund ta gjeni në web faqen e Komitetit të Helsinkit, në seksionin raporte (<http://www.mhc.org.mk/pages/reports#.URJveB1X0I8>)

dhe pamjen reale të ngjarjeve. Deri në publikimin e këtij raporti, komisioni në fjalë nuk është formuar e as nuk janë vërtetuar gjendjet si për deputetët, ashtu edhe për gazetarët që u nxorren me forcë nga Galeria e Parlamentit.

Komiteti me shqetësim konkludon se veprimet e tilla janë një goditje ndaj rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë dhe ngjarjet paraqesin një precedent të frikshëm të paparë, në kundërshtim me parimet themelore të shtetit juridik dhe sundimit të së drejtës.

3. Të burgosurit politikë dhe presioni politik

Presion politik për shkak të anëtarësisë në parti politike

- Partia politike „Të bashkuar për Maqedoninë“: Gjatë vitit 2012, Komiteti vërtetoi presion politik përmes shfrytëzimit të sistemit gjyqësor ndaj dy anëtarëve të partisë politike „Të bashkuar për Maqedoninë“, Vladimir Vangelov dhe Mitko Janevski. Komitetit të Helsinkit iu drejtuan përfaqësues të Kryesisë së partisë politike „Të Bashkuar për Maqedoninë“ dhe paraqitën pretendimet për presione të shtuara ndaj tyre personalisht si dhe ndaj partisë së tyre. Presioni zakonisht është në formën e frikësimit, kërcënimeve, orvatjeve për ryshfet, pushim nga puna, premtime për vende pune për ata që largohen nga partia, etj. Sipas pretendimeve, gjatë largimit nga ish ambientet e zyrës qendrore të partisë, anëtarë të mëparshëm të partisë dhe individë të tjerë të panjohur kanë shkatërruar një bazë të dhënash që përmbante dokumente të rëndësishme në lidhje me partinë, kurse janë zhdukur një numër i madh i fletëparaqitjeve dhe shënimeve të shkruara. Ekziston një ndjenjë në parti se ky është një veprim i koordinuar për të shkatërruar partinë, një veprim që filloi me ndjekjen penale të kryetarit të partisë - Ljube Boshkoski, ndjekja penale e të cilit vazhdon deri më sot.

• **Vlladimir Vangellov**

Vangell Vangellov, gjithashtu anëtar i „Të bashkuar për Maqedoninë“, iu drejtua Komitetit të Helsinkit, duke na informuar se prona e nënës së tij në Komunën e Zelenikovës ishte uzurpuar, pa filluar procedura e shpronësimit. Kryetari i komunës kishte dhënë leje për ndërtimin e një rruge lokale që kalon nëpër pronën e familjes Vangelov, megjithëse familja disa herë e ka informuar se bëhet fjalë për pronë private. Gjatë ndërtimit të rrugës, u shkatërruan disa pemë frutore dhe plepa. Me këtë veprim u bë shkelje serioze e të drejtës së pronës, e drejtë kjo e mbrojtur dhe e garantuar me Kushtetutën e RM - së. Pas disa njoftimeve verbale, z. Vange-

lov dorëzoi ankesë me shkrim drejtuar kryetarit të komunës, pas së cilës morri përgjigje se "shpifja" që z. Vangelov po e bën kundër komunës dhe kryetarit të komunës, përmes reagi-meve në institucionet dhe mediat, është „ndoshta” rezultat i përkatësisë së tyre të ndryshme politike. Komiteti i Helsinkit mori pjesë në disa seanca gjyqësore në të cilat palë e pandehur është komuna dhe do të vazhdojë të ndjekë çështjen deri në përfundim gjyqësor. Deri në momentin e publikimit të raportit, çështja, pas ankesës në Gjykatën e Apelit, u kthye në procedurën e shkallës së parë.

- **Mitko Janevski**

Për presionin që bëhet mbi anëtarët e „Të bashkuar për Maqedoninë” dëshmon edhe rasti i Mitko Janevskit, këshilltar me titull diplomatik të Sekretarit të Parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në rastin e Mitko Janevskit shqyrtohen pretendimet për presion në vendin e punës, në dy baza: përkatësi politike dhe orientimi seksual. Gjegjësisht, Mitko Janevski është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme tani më 26 vite dhe presionet e para që përmendi i ka ndjerë në vitin 2009, pas kthimit të parakohshëm nga Përfaqësia diplomatike konzullore në Venedik, gjë që konfirmon përvojën e tij diplomatike dhe angazhimin në diplomacinë e Republikës së Maqedonisë. Që nga viti 2009, Janevski vazhdimisht ka kërkuar ngritje në punë, por nga kompetentët në Ministri ka marrë përgjigje negative dhe refuzimi i fundit është regjistruar në vitin 2011 në një konkurs për plotësimin e një vendi pune në Ambasadën e Republikës së Maqedonisë në Beograd. Komiteti i dha ndihmë juridike falas Janevskit, i cili pretendon se që nga viti 2009 pati shtypje, fillimisht për shkak të orientimit homoseksual, e më pas për shkak të anëtarësimit në parti politike „Të bashkuar për Maqedoninë”. Deri në publikimin e këtij raporti, Janevski u tërhoq nga lufta për vendin e punës, megjithatë Komiteti regjistroi presionin e natyrës politike, kur ai mori kërcënime për jetën për shkak të përkatësisë në parti dhe sipërpërmendur, kurse pas kësaj ai u largua nga Republika e Maqedonisë për një kohë të pacaktuar.

Ky rast paraqet dëshmi të presionit që ushtrohet mbi qytetarët me përkatësi të ndryshme politike nga partia në pushtet. Konsiderojmë se veprimet e këtilla janë të palejueshme në një shoqëri demokratike, ku një nga vlerat themelore është pluralizmi politik dhe me këto veprime rrezikohet drejtpërsëdrejti neni 20 i Kushtetutës së RM - së, i cili garanton lirinë dhe mbrojtjen e të drejtave politike dhe bindjeve të qytetarëve, që çon në rrezikimin e sigurisë dhe rrezikimin e të drejtës për jetë.

- **Çështja gjyqësore Dushko Ilievski për shkak të gjoja lidhjes me një parti të opozitës**

Pas më shumë se dy vitesh, Dushko Ilievski, i njohur në opinion si Dushko-qumshtaxhiu, u shpall i pafajshëm në procesin gjyqësor, në të cilin ai, vëllai dhe babai i tij u ndoqën penalisht për vepër të pretenduar penale „prodhim dhe shpërndarje të paautorizuar në qarkullim të substancave narkotike, psikotrope etj.”, gjegjësisht kultivim të mbi 200 fidanëve marihuanë.

Gjatë procesit gjyqësor u konstatua se bëhet fjalë për bimë kanabisi që mbin vetëvetiu, gjegjësisht konop i cili pa përpunim shtesë nuk posedon vetitë e një droge narkotike. Meqenëse Prokuroria Publike nuk arriti të dëshmojë se anëtarët e familjes Ilievski vetë e kanë mbjellë, kultivuar ose përpunuar konopin, të pandehurit u liruan nga akuza.

Dushan Ilievski është i bindur se procesi gjyqësor kundër tij dhe anëtarëve të familjes së tij, ka prapavijë politike për shkak të funksionit të tij, përkatësisht Kryetar i Shoqatës së Fermerëve të Pellagonisë „Pellagonija-rilindja“, gjegjësisht për shkak të përpjekjeve të fermerëve që përmes protestave të marrin përgjigje në pyetjet lidhur me zhvlerësimin e qumështores „Swedmilk“ dhe nëse përfaqësuesit e qeverisë aktuale luajtën rol në ato veprime. Këtu fillojnë edhe presionet ndaj Dushkos, më saktë në vitin 2009, kur shtëpia e tij familjare kontrollua në kërkim të armëve të paligjshme. U gjet një armë gjuetie për të cilën ai kishte leje. Gjithashtu SPB Manastir, kundër tij dhe mbi 20 pjesëmarrësve të tjerë në protesta, ngrii akuzë për kundërvajtje për gjoja prishje të rendit dhe qetësisë publike gjatë një proteste para ndërtesës së komunës në Manastir. Me vendim të gjykatës, të gjithë të paraqiturit, u liruan nga përgjegjësia. Pastaj, në 2010, vijon kallëzim penal për kultivim të marihuanës dhe përcaktim i masës së paraburgimit, ndaj të cilit Komiteti reagoi në mënyrë përkatëse.

Çështjen gjyqësore kundër Dushko Ilievskit dhe të tjerëve, Komiteti e konsideron rast në të cilin nga zyrtarët shtetërorë, por edhe nga organet e ndjekjes, haptazi u shkel parimi i prezumimit të pafajësisë. Menjëherë pas arrestimit të Dushko Ilievskit, njëherit edhe para fillimit të procesit gjyqësor, Kryeministri Nikolla Gruevski doli me konstatim, gjegjësisht akuzë se bëhet fjalë për marihuanë të kultivuar. Edhe pse verdikti shfajësues tregon se deklarata e Kryeministrit ishte e pasaktë, megjithatë deklarata u transmetua në pjesën më të madhe të mediave në Maqedoni, e cila përveç prezumimit të pafajësisë, çënoi privatësinë, reputacionin, nderin dhe dinjitetin e Dushko Ilievskit dhe anëtarëve të familjes së tij. Komiteti i Helsinkit përkujton se askush nuk guxon të shpallet fajtor, pa u vërtetuar faji paraprakisht me vendim gjyqësor. Komiteti edhe një herë përqëndron vëmendjen në parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila thotë se autoritetet duhet të përmbahen nga paragjykimi i fajit. Kjo veçanërisht vlen për deklaratat e bëra nga ministrat, policia¹⁸ dhe zyrtarë të lartë (siç është kryeministri)¹⁹. Për më tepër, Gjykata e Strasburgut vendosi që zhvillimi i fushatës mediatike negative ndaj të dyshuarve ose personave të akuzuar dhe paragjykimi i fajit të tyre, gjithashtu nuk lejohet sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁰.

Komiteti i Helsinkit mirëpret vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit në Manastir dhe paanësinë e këshillave gjyqësore përkatës gjatë veprimit të pavarur në këtë çështje. Nga ana tjetër, Komiteti shpreh keqardhje për të gjitha shqetësimet me të cilat është përballur Dushko „qumshtaxhiu“ në tre vitet e fundit. Për shkak të mungesës së vullnetit të disa avokatëve që Dushko i kontaktoi për përfaqësim në procedurën për kompensimin të dëmit për privim

18 Alenet de Ribemont kundër Francës (15175/89), 10 shkurt 1995, \$41

19 Butkevičius kundër Lituaniës (48297/99), 26 mars 2002, \$53

20 Kraksi kundër Italisë (34896/97), 5 dhjetor 2002, \$98

të padrejtë të lirisë, si dhe dëmeve tjera materiale (plantacione të shkatërruara dhe fitime të humbura) dhe dëme jomateriale (dhimbje shpirtërore, dëmtim të reputacionit, nderit, etj.), Komiteti i Helsinkit, me kërkesë të Dushkos, ra dakord t'i sigurojë ndihmë juridike falas. Deri në publikimin e këtij raporti, Komiteti informon se para gjykatës kompetente ka filluar procedura e kompensimit të dëmit.

3.2. Të burgosurit politikë

Duke vepruar në pajtim me programin e punës, pjesë e të cilit është monitorimi i procedurave penale, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2012 monitoroi dy proceset gjyqësore, ku si i pandehur është kryetari i partisë politike „Të bashkuar për Maqedoninë“ Ljube Boshkovski. Në dy proceset gjyqësore kundër të pandehurit, Komiteti gjeti abuzim me masat e posaçme hetimore dhe elementë kontestues në procedurën me dëshmitarin e mbrojtur, në deklaratën e të cilit edhe bazohet njëri nga aktgjykimet dhe Boshkovski fillimisht u dënua me 7 vjet burg. Aktgjykimi u apelua dhe u pranua pjesërisht nga Gjykata e Apelit në Shkup, kështu që dënimi u ul në 5 vjet. Gjegjesisht, Komiteti konsideron se ekziston dyshim i arsyeshëm se Ljube Boshkovski mund të konsiderohet i burgosur politik, duke pasur parasysh rrethanat dhe zhvillimin e procedurës.

Në procesin e parë gjyqësor, në të cilin Boshkovski akuzohet për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore, Komiteti i Helsinkit reagoi se çështja ose gjykimi kryesor u mbajt me dyer të mbyllura dhe u përjashtua publiku. Shqetëson dyshimi se lidhur me këtë rast, u keqpërdorën masat e veçanta hetimore, kurse i paqartë mbeti edhe ndryshimi i përbërjes së gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Shkupit²¹. Gjatë procedurës, Boshkovski theksoi se nuk ishte në gjendje të reagojë ndaj vendimit të Gjykatës Themelore Shkupi 1 Shkup, sepse ishte „i droguar“ dhe se kundër tij po zhvillohej një „proces i montuar politik“. Këto pretendime nuk u mohuan dhe as nuk u verifikuan nga autoritetet kompetente. Në një pjesë të madhe të procesit gjyqësor, publiku u përjashtua, me arsyetim se po përdoren masa të posaçme hetimore, gjegjesisht „dëshmitar i mbrojtur“, ndërsa aktvendimi bazohet kryesisht në atë deklaratë.

Për më tepër, në vitin 2012, një proces tjetër gjyqësor u hap kundër të pandehurit, i njohur në opinion si „Rover“, në të cilin i pandehuri Ljube Boshkovski akuzohet për ndihmë në kryerje të veprës penale duke hequr pengesat për kryerje dhe premtim për mbulim të veprës penale, në kohën kur kryente funksionin publik të Ministrisë të Brendshme. Duke vepruar në pajtim me programin e punës në të cilin monitorimi i procedurave penale është një nga aktivitetet, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut filloi të ndjekë procesin gjyqësor për vrasjen e personave Marijan Tushevski dhe Kiro Janev, të kryer në vitin 2001. Për vrasjen e dyfishtë u

21 Komiteti i Helsinkit e konstatoi si simptomatik momentin e ndryshimit të përbërjes së gjykatësve gjatë gjykimet, për çka edhe sot e kësaj dite nuk është dhënë kurrfarë shpjegimi nga ana e gjyqit. Sipas rregullores së Gjykatës së Apelit, lëndët gjyqësore u caktohen gjykatësve në fillim të vitit dhe ndryshime mund të bëhen vetëm në rast të mungesës së gjykatësve. Lënda gjyqësore e Ljube Boshkovskit, fillimisht iu caktua gjykatëses Katerina Orovčanec, kurse pak para shqyrtimit, iu caktua gjykatësit mr. Safet Kadrii, si kryetar i Këshillit dhe anëtarëve të Këshillit, Mirjana Dukovska, Zuica Naumova, Gordana Sajkovska dhe Vellçe Pancevski.

akuzuan pesëmbëdhjetë persona, tre prej tyre për ekzekutim të drejtpërdrejtë dhe 12 të tjerët për ndihmë.

Në rastin „Rover“ gjithashtu u përdor masa e posaçme hetimore „dëshmitar i mbrojtur“. Duke vlerësuar rëndësinë e rolit të dëshmitarëve të mbrojtur në procedurat penale dhe mënyrën e zbatimit të marrjes në pyetje, prof.Dr. Gordan Kallajxhiev njohtoi Gjykatën Themelore Shkupi 1 Shkup, se në rolin e punëtorit shkencor, profesor i procedurës penale në Fakultetin e Drejtësisë „Justiniani I“, në Universitetin „Shën Kirili e Metodi“, do të vëzhgojë gjykimin. Pëlqim pozitiv që opinioni profesional të mos përjashtohet nga marrja në pyetje e dëshmitarit të mbrojtur, dha edhe prokurorja publike, si përfaqësuese e prokurorisë dhe propozuese e dëshmitarit, me çka për herë të parë prokuroria publike tregoi vullnet për transparencë më të madhe në procedurën e dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur. Megjithatë, këshilli vendosi të përjashtojë tërësisht publikun, përfshirë edhe publikun profesional.

Ne besojmë se vendimet e vazhdueshme të këshillave për të përjashtuar publikun në rastet kur paraqiten dëshmitarë të mbrojtur, nuk sigurojnë hapësirë për të vërtetuar nëse është realizuar parimi i gjyimit të drejtë dhe fer. Në veçanti, nuk e konsiderojmë të justifikuar përjashtimin e publikut profesional, i cili vetëm se do të ndiqte mënyrën e veçantë të dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur, me qëllim të vërtetimit të zbatimit të dispozitave ligjore me të cilat është rregulluar mënyra e mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimin e saj në parimin e gjyimit të drejtë dhe fer.

Për më tepër, në dy raportet vjetore të njëpasnjëshme të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve mbi situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Maqedonisë, ose për vitet 2011 dhe 2012, u shtua kategoria „Të burgosur politikë dhe të paraburgosur“, e cila gjithashtu merret me proceset gjyqësore kundër Ljube Boshkovskit. Ato vlerësohen si procedura jotransparente të organeve shtetërore. Kritikat përqëndrohen kryesisht në shkeljen e së drejtës për prezumimin e pafajësisë si dhe përdorimin e masave të posaçme hetimore, përkatësisht rolin e dëshmitarit të mbrojtur.

Komiteti i Helsinkit kundërshton me forcë përpjekjet për të përjashtuar publikun, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje me prapavijë politike, gjë që lë hapësirë për dyshime se ekziston një tendencë për fshehje, veçanërisht nëse merren parasysh dyshimet për keqpërdorim të masave të posaçme hetimore në procedurë.

4. Shkelja e parimit të sekularizmit të shtetit

Duke pasur parasysh karakterin e qartë laik, ose ndarjen e kishës nga shteti, të konstituuar si një shtet sovran, i pavarur si dhe civil dhe demokratik, vlera themelore e të cilit është ndërtimi i sundimit të së drejtës dhe ndarja e pushtetit në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, Komiteti u bën thirrje përfaqësuesve të dy Bashkësive më të mëdha fetare dhe subjekteve të tyre juridikë, Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM) dhe Bashkësisë Fetare Islame (BFI, të përmbahen

nga ndërhyrja në politikë, rregullimin shtetëror dhe nxitje të ndarjes ndërfaqetare dhe ndërretnike midis qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky reagim i Komitetit bazohet në deklaratat e fundit të kreut të KOM, z.z. Stefan dhe kreut të BFI-së, Reis Sulejman Ul Ulema Efendi Rexhepi dhe thirrjeve ndaj besimtarëve për bashkim kombëtar. Deklaratat e tilla dhe deklarimet e udhëheqësve fetarë për sovranitetin e paprekshëm që del nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe e drejta ndërkombëtare, mund të keqinterpretohen dhe të thellojnë tensionet etnike ndërmjet qytetarëve që i përkasin bashkësive etnike maqedonase dhe shqiptare²². Njëherit, shpërfillja e grupeve të tjera fetare, lidhja e ngushtë e fesë me unitetin kombëtar të grupeve etnike individuale, deklaratat e udhëheqësve fetarë dhe thirrjet ndaj qytetarëve, mund të shkaktojnë ndarje të thella mbi baza fetare, të thellojnë ndarjen tashmë të madhe etnike dhe të kontribuojnë në shkeljen e sovranitetit i cili, sipas nenit 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, buron dhe u përket të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë.

22 Me nenin 19 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë është e rregulluar se Kisha Ortodokse Maqedonase si dhe Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha metodike ungjillore, komuniteti hebre dhe bashkësitë tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të njejta para ligjit. Nga kjo është e qartë se në Republikën e Maqedonisë nuk ka religjion shtetëror. Shteti është sekular dhe religjioni është i ndarë prej saj. Kjo do të thotë se shteti nuk ka të drejtë të përzihet në çështjet e kishës, e as kisha të përzihet në çështjet shtetërore. Me Ligjin për organet e administratës shtetërore, është themeluar Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze si organ i veçantë në administratës shtetërore. Ky organ ka status të personit juridik. Në nenin 29 të këtij Ligji është definuar se Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze kujdeset për pozitën juridike të bashkësive fetare dhe grupeve religjioze dhe për marrëdhëniet ndërmjet shtetit, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze.

X. KOMUNITETI LGBTI

1. Hyrje

Për fat të keq, edhe në vitin 2012, personat LGBTI në Republikën e Maqedonisë u përballën me paragjykime juridike dhe shoqërore, diskriminim, si dhe një mjedis jashtëzakonisht homofobik që ndikon në qasjen në legjislacion dhe mbrojtje ligjore. Njerëzit e këtij komuniteti janë të detyruar t'i përshtaten një shoqërie dhe mjedisi tepër homofob dhe transfobik. Gjithashtu, këta njerëz nuk konsiderohen qytetarë me të drejta dhe liri të barabarta në bazë të dhe para ligjeve të shtetit. Përgjatë viteve, organi ligjvënës nuk ka treguar gatishmëri për të përmirësuar qasjen në drejtësi dhe gëzimin e plotë të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe dokumentet ndërkombëtare, që janë pjesë integrale e aktit më të lartë juridik. Janë miratuar disa ligje që duhej të miratoheshin si pjesë e procesit të integritimit në BE, por ekziston dyshimi i zbatimit pa veprim më të gjerë të shtetit në fushën e barazisë së personave LGBTI. Komuniteti LGBTI është praktikisht i padukshëm dhe nuk ka ndihmë të mjaftueshme e cila u nevojitet për të siguruar qasje në drejtësi, një jetë aktive dhe të përmbushur, si pjesa tjetër e qytetarëve të shoqërisë në të cilën jetojmë.

2. Qendra e Mbështetjes LGBTI

Tre vjet pas themelimit të programit LGBTI në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë (KHM), ai mori një formë të re, më të përparuar, në formën e Qendrës së Mbështetjes LGBTI. Kjo degë e KHM u hap zyrtarisht më 23 tetor 2012 në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

Qendra LGBTI filloi të funksionojë në një periudhë të definuar qartë të homofobisë dhe transfobisë së institucionalizuar, e shprehur në deklaratat e njerëzve që drejtojnë institucionet shtetërore. Ekziston një sinergji e dukshme midis veprimeve të institucioneve shtetërore dhe drejtuesve të tyre, veprimeve të bashkësive fetare dhe mediave proqeveritare, që paraqet një front të madh të orientuar në shtypjen e personave LGBTI dhe heqjen e të drejtave të tyre. E gjithë kjo konfirmohet me raste të qarta të sulmeve fizike, si dhe dhunës në familje ndaj personave, organizatave dhe aktivistëve LGBTI, për të cilat do të shkruajmë në vazhdim të këtij Raporti. Kjo homofobi e fortë e institucionalizuar ka forcuar dhe përcaktuar mbështetjen e popullatës LGBTI nga organizatat dhe aktivistët e të drejtave të njeriut, duke e interpretuar këtë fushatë si një absurditet që duhet të marrë fund.

Është e rëndësishme që kemi bashkëpunim të mirë me stacionet përkatëse të policisë Beko dhe Bit Pazar, të cilat bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe i sigurojnë ngjarjet e organizuara nga Komiteti i Helsinkit dhe Qendra e Mbështetjes. Sulmuesi i Marshimit të Tolerancës u arrestua shumë shpejt dhe procedura kundër tij ka filluar. Një nga sulmuesit e Qendrës e kishte regjistruar veten në kamerën e sigurisë së Qendrës, në përpjekje për ta thyer atë, në mënyrë që të gjitha materialet iu dorëzuan policisë dhe presim një hetim cilësor dhe

veprime të mëtejshme. Jemi në komunikim të vazhdueshëm me stacionin policor Bit Pazar, në lidhje me sigurinë e Qendrës.

Misioni i Qendrës për Mbështetje LGBTI është të forcojë komunitetin LGBTI për vetavokim, si dhe të ndryshojë statusin juridik dhe shoqëror të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë. Përveç qëllimit kryesor, Qendra ofron asistencë edhe për shoqata dhe grupe të tjera formale dhe joformale që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Përveç hapjes së Qendrës, në vitin 2012, lëvizja LGBTI u rrit me formimin edhe të një organizate tjetër, LGBT United, me seli në Tetovë.

3. Homofobia

Në Republikën e Maqedonisë, homofobia dhe transfobia ende janë në një nivel të lartë, gjë që mund të shihet përmes shprehjes së mendimeve në rrjetet sociale, sulmeve ndaj Qendrës së Mbështetjes, gjuhës së urrejtjes në media, sulmeve ndaj aktivistëve të Marshit të organizuar të tolerancës dhe heshtjes së institucioneve qeveritare, të cilat nuk e dënuan përhapjen e urrejtjes ndaj një grupi të caktuar njerëzish dhe nxitën përjashtim nga shoqëria, e poashtu nuk e dënuan shkeljen e ligjeve ekzistuese. Përkundrazi, Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, i cili ngriti çështjen e të ashtuquajturave „martesa homoseksuale” në një kohë kur askush nuk kishte ndërmarrë një iniciativë të tillë, në vend që të promovonte dallimet në shoqërinë, ku ai është më përgjegjësi për çështje të tilla, stigmatizoi popullatën LGBTI, duke thënë se nuk i përket një „kombi të shëndetshëm”. Pas deklaratave të Ministrit Spiro Ristovski, pati një valë të fortë të fushatës së dukshme qeveritare që përmbante deklarata homofobike dhe mosrespektim të të drejtave dhe dinjitetit të popullatës LGBTI në Maqedoni. Deklaratat e përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore vetëm sa forcuan idenë dhe statusin e popullatës LGBTI në shoqëri, si devijim. Fushata u mbështet dhe u përforcua nga artikujt në mediat pro-qeveritare, të cilat harruan ose anashkaluan përgjegjësinë për deklaratat dhe artikujt që i botonin, të cilat padyshim nxitën zemërim dhe homofobi tek qytetarët, gjë që rezultoi me dhunë. Pas deklaratave të përfaqësuesve të Qeverisë, Ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, Ministres së Brendshme dhe Kryeministrit, grupe të caktuara gjithashtu shprehën qëndrimet e tyre për mbështetjen e përfaqësuesve qeveritarë në lidhje me martesat e gjinisë së njejtë, që u hap si temë nga Ministri, pa kurrfarë iniciative në prapavijë, dhe ishte vetëm shprehje e mendimit të tij personal, si dhe qëndrimin të partisë së tij politike, që është plotësisht absurde, duke pasur parasysh faktin se një çështje e tillë nuk është ngritur kurrë nga komuniteti LGBTI në vend. Duket se kjo është përpjekje për të shtrembëruar debatin dhe për të shmangur diskutimin për problemet e vërteta në ushtrimin e të drejtave të personave LGBTI, si dhe shtrembërimin e iniciativës së KHM-së në Gjykatën Kushtetuese, në lidhje me mbrojtjen e personave LGBTI nga dhuna në familje, të përfshirë në Ligjin për familjen. Gjatë deklaratave të këtyre grupeve për kundërshtimin ndaj martesave homoseksuale, u sulmua integriteti i komunitetit, sepse të gjitha këto grupe reagueshan për çështje që nuk është ngritur kurrë, ndërsa askush nuk komentoi për iniciativat aktuale të aktivistëve dhe organizatave, siç është shtimi i orientimit seksual në

Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, shtimin e marrëdhënieve të gjinisë së njejtë në kategorinë e marrëdhënieve të afërta personale, me qëllim që të mundësohet mbrojtje nga dhuna në familje midis partnerëve të së njejtës gjini, si dhe personave homoseksualë dhe trans, që nuk mbrohen nga familjet e tyre.

Përndryshe, deklarata për mospraninë e „martesave gej“, dhanë: Ministri i Punës dhe Politikës Sociale Spiro Ristovski, Kongresi Botëror Maqedonas, Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha Ortodokse Maqedonase, Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve, Lidhja Socialdemokrate, Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Maqedonisë, organizatat e Strugës Ezerka dhe Qendra e saj Rinore, Enhalon, kulti Rurban, Punte, Varvara, Shoqata e të Shurdhërve dhe me Vështirësi në Dëgjim dhe Svetlina, federatat kombëtare të sporteve dhe Ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska.

Bashkësitë fetare, së bashku me institucionet shtetërore, iu bashkuan ortekut të deklaratave kundër martesave homoseksuale dhe birësimit të fëmijëve nga partnerë të të njejtës gjini, si pjesë e një fushate të organizuar. Me deklarata që promovojnë gjuhën e urrejtjes dhe paraqesin vlerat tradicionale heteronormative fetare si vlerat e vetme të drejta, ata përpiqen të përdorin fenë për të ndikuar në statusin e një grupi qytetarësh në një shtet sekular. Kjo nuk është hera e parë që komunitetet fetare përpiqen të ndërhyjnë në sistemin shtetëror, kur bëhet fjalë për komunitetin LGBTI.

Qasja në media e aktivistëve dhe organizatave që punojnë me komunitetin LGBTI është e kufizuar, selektive dhe shpesh e shtrembëruar. Ekziston një lidhje e dukshme e medimeve të caktuara me qeverinë, dhe si pasojë, plasimi i informatave, ishte ose i pamundshëm ose joobjektiv, duke ofruar vështrim të njëanshëm të situatës në Maqedoni.

Përveç kufizimit të hapësirës mediatike, mund të vërehej se medime të caktuara drejtpërsëdrejti morrën pjesë në fushatën homofobike, duke paraqitur informata subjektive, të bazuara në pikëpamjet personale.

4. Avokimi dhe lobimi

4.1 Iniciativë para Gjykatës Kushtetuese

Në Ditën Ndërkombëtare të luftës kundër homofobisë, 17 maj, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë paraqiti një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94-b, paragrafi 3, të Ligjit për Familjen, ku pjesëtarët e komunitetit LGBTI (lezbike, burra homoseksualë, biseksualë, transgjjinorë dhe persona interseksualë) nuk janë të përfshirë në mbrojtjen nga dhuna në familje. Në nenin 94-b, paragrafi 3, të Ligjit për Familjen, ligjvënësi ka përfshirë edhe marrëdhëniet e ngushta personale si bazë, sipas së cilës personat që kanë marrëdhënie të tilla gëzojnë mbrojtje ligjore nga dhuna në familje. Paragrafi i kontestuar 3 i Nenit

94-b marrëdhëniet e ngushta personale i përcakton si marrëdhënie personale midis personave të gjinisë së ndryshme, të cilët janë ose kanë qenë në lidhje partneriteti, kurse nuk jetojnë në një bashkësi jashtëmartesore. Por, Ligji e përcakton ngushtë kategorinë e marrëdhënieve të ngushta personale, e cila paraqet kategori më të gjerë se martesë, familja dhe bashkësia jashtëmartesore, sepse përfshin një numër shumë më të madh të personave që janë ose kanë qenë në partneritet me persona të tjerë, por që nuk kanë jetuar në një bashkësi jashtëmartesore, e të cilët mund të jetë viktimë e dhunës në familje. Me një përkufizim kaq të ngushtë dhe të kufizuar të marrëdhënieve të ngushta personale si marrëdhënie personale midis personave të gjinive të ndryshme, ligjvënësi ka bërë diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave të tjerë që kanë marrëdhënie personale me persona të të njejtës gjini dhe ata duhet të përfshihen në kategorinë e marrëdhënieve të ngushta personale, të përfshira me ligj.

Gjykata Kushtetuese më vonë hodhi poshtë²³ Iniciativën e paraqitur nga Komiteti i Helsinkit. Me qëndrime dhe vendime të tilla, një popullatë e tërë është diskriminuar drejtpërsëdrejti, është lënë jashtë kornizës ligjore dhe pa mbrojtje nga dhuna në familje.

4.2 Raport në hije për zbatimin e Rekomandimit CM / Rec (2010) 5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CoE) për luftën kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor

Me qëllim të një analize të hollësishme të shoqërisë përnga aspekti i betejës kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, gjatë përgatitjes së Raportit, komunikua me të gjitha institucionet kyçe shtetërore në fushat specifike të cilave u dedikohen Rekomandimet e CoE. Gjithashtu, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme (e ngarkuar për shpërndarjen dhe zbatimin e Rekomandimit) ia dolëm që Republika e Maqedonisë të përfshihet në grupin e vendeve që iu përgjigjën Pyetësorit vijues, të cilin Komiteti i Ministrave i CoE ia dërgoi shteteve anëtare, para se të shqyrtonte zbatimin e Rekomandimit të planifikuar për në mars 2013. Ajo që mund të konkludohet nga Raporti është se autoritetet maqedonase nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapash për të zbatuar Rekomandimin e Këshillit të Evropës. Rekomandimi madje as që ishte përkthyer në gjuhën maqedonase, kurse shpjegimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme është se rekomandimet e CoE nuk janë të detyrueshme për vendet anëtare. Njëherit, Rekomandimi nuk u është dërguar institucioneve kompetente, organizatave joqeveritare dhe vetë komunitetit LGBTI. KHM u dorëzoi ekzemplarë të Rekomandimit të gjitha institucioneve kompetente gjatë implementimit të këtij projekti. Rekomandimi i përkthyer dhe shtojcat e tij u janë dërguar të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

23 <http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf/ffc0feee91d7bd9ac1256d280038c474/3068a98885792e05c1257ad1003bfc9f?OpenDocument>

Një pjesë e konkluzioneve të Raportit në hije:

- Orientimi seksual u hoq nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi si një bazë e veçantë, ndërsa identiteti gjinor nuk u mor fare parasysh gjatë hartimit të Ligjit.

- Interesat dhe nevojat e komunitetit LGBTI nuk u morën parasysh gjatë përgatitjes dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare për barazinë dhe mosdiskriminimin, e cila mbulon vetëm katër baza: përkatësinë etnike, moshën, aftësitë e kufizuara mendore dhe fizike.

-Çiftet e të njejtës gjini janë të diskriminuara në Ligjin e Familjes në lidhje me çiftet me partnerë të gjinive të ndryshme, por kompetentët nuk marrin masa për zgjidhjen e këtij problemi. Çiftet e të njejtës gjini nuk janë të mbrojtur nga dhuna në familje, në kuadër të Ligjit për Familjen.

- Nuk ekzistojnë procedura të përcaktuara saktë dhe qartë për ndryshimin e numrit amë, që është i domosdoshëm për njohjen ligjore të ndryshimit të gjinisë në rastin e një personi transgjinor, gjë që krijon konfuzion në veprimet, si tek nëpunësit shtetërorë, ashtu edhe tek vetë personat transgjinorë.

-Megjithëse shteti ofron trajtim endokrinologjik dhe psikologjik, për të cilin kanë nevojë personat transgjinorë, ato nuk janë as efektive dhe as të përshtatshme, pasi që nuk ekziston praktikë ose trajnim për punëtorët profesionalë shëndetësorë për rastet e personave transgjinorë. Përveç kësaj, shteti nuk ofron ndërhyrje kirurgjikale për ndryshimin e gjinisë dhe nuk ka prova për rimbursim të mjeteve nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, madje as në rastet kur personat e kanë kryer operacionin jashtë vendit, me mjete të veta financiare.

-Në fushën e sportit, organet shtetërore nuk kanë bërë absolutisht asgjë për të kapërcyer diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe gjuhën e urrejtjes.

-Në shëndetësi, përveç programeve parandaluese dhe studimeve bihejvioriste në kuadër të Fondit Global për luftë kundër HIV / AIDS (Sidës), Malarias dhe Tuberkulozit, nuk ekzistojnë programe dhe shërbime të tjera në dispozicion të personave LGBTI.

- Megjithëse në klasifikimin tonë të sëmundjeve, orientimi seksual nuk është një sëmundje, në librat shkollorë të arsimit të mesëm dhe të lartë, autorët përdorin interpretime, pikëpamje dhe klasifikime që nuk bazohen në mendimin shkencor bashkëkohor dhe definicionet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe nuk janë në përputhje me dokumentet ekzistuese zyrtare për klasifikimin e sëmundjeve / çrregullimeve.

-Në Ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohshme, orientimi, seksual dhe identiteti gjinor i një personi të caktuar, nuk janë përfshirë si arsye të veçanta për shkak të të cilave një

person i caktuar mund të kërkojë azil, por të njejtit mund të jenë bazë për dhënien e statusit të refugjatit sipas dispozitës „përkatësi në një grup të caktuar shoqëror“. Megjithatë, nuk ka shembuj ose raste të dokumentuara që do të dëshmonin se një refugjati i është dhënë statusi i refugjatit për shkak të orientimit të tij seksual ose identitetit të tij gjinor.

Raportin e plotë në hije mund ta gjeni në faqen tonë të internetit (<http://www.lgbti.mk/>)

5. Ndhimë juridike

Qendra për Mbështetjen e Popullatës LGBTI ndihmën juridike falas e ofron si pjesë e Komitetit të Helsinkit, për anëtarët e komunitetit LGBTI, të drejtat e të cilëve janë shkelur. Gjatë kohës së shkurtër të ekzistimit të qendrës, tashmë janë shfaqur tri raste të dhunës në familje, si dhe disa raste që trajtojnë probleme të tjera, por akoma shqyrtohen nën diskrecion, për shkak të frikës nga paragjykimi i institucioneve.

Raste

1. Një burrë homoseksual që jetoi me partnerin e tij në Shkup ishte viktimë e dhunës fizike dhe psikologjike për më shumë se 6 muaj. Ai pësoi dy sulme fizike dhe maltretim të vazhdueshëm psikologjik. Ai iu drejtua Komitetit të Helsinkit me kërkesë për ndihmë juridike falas. Një përfaqësues i Komitetit e shoqëroi atë për të bërë një ankesë në stacionin e policisë, ku për herë të parë nëpunësja e policisë tregoi ndjeshmëri mbi temën dhe gatishmëri për të ndihmuar. Për shkak të mungesës disaditore në banesën ku jetonte me partnerin e tij, nga frika se mos sulmohet përsëri, ai nuk ka mundur t'i marrë nga banesa gjërat e veta.

Në Ligjin për dhunën në familje, në „marrëdhënie të afërta personale“ nuk përfshihen edhe partneritete të të njejtës gjini, kështu që ato nuk mbrohen në mënyrë specifike, dhe për këtë shkak, përfaqësuesi i Komitetit në ankesë theksoi se bëhet fjalë për dhunë në familje midis personave që jetojnë në amvisëri të përbashkët, kurse Ligji për Dhunën në Familje dhe Kodi Penal i njeh si „persona të tjerë që jetojnë në amvisëri të përbashkët“ për të cilën është deklaruar edhe vete gjykata.

Nëpunësja e policisë informoi se do ta thërriste në bisedë partnerin i cili është autor i dhunës. Gjatë bisedës, viktima mori gjërat që ishin pronë e vetja nga banesa dhe u vendos në një vend tjetër, të panjohur për autorin e dhunës fizike dhe psikologjike.

Rasti u mbyll me sukses, me që viktima nuk ishte e interesuar për ndonjë veprim tjetër.

Pas një kohe, autori i dhunës e ka vizituar viktimën në vendin e punës dhe e ka shqetësuar përsëri, dhe për këtë gjë u dha edhe një denoncim. Kryerësi i dhunës është thirrur përsëri për bisedë në polici dhe pas kësaj ngacmimi është ndërprerë deri në ditën e sotme.

2. Pranë Komitetit u raportua edhe një rast tjetër, ku prindërit e një vajze i kanë bërë presion partneres së saj përmes kërcënimeve. Prindërit e kanë maltretuar vajzën e tyre në mënyrë psikike dhe fizike, me qëllim që ajo të mos vinte në kontakt me partneren e saj. Megjithëse çështja u regjistrua në Komitetin e Helsinkit, partnerja për shkak të presionit, vendosi të largohej nga shteti dhe dy vajzat u tërhoqën nga vazhdimi i procesit.

3. Në shkurt të vitit 2012, Andrea Jakimovski, i cili është një person transgjjinor (që identifikohet si grua, pavarësisht se ka karakteristikat biologjike të një mashkulli) ngriti kallëzim penal kundër Spitalit të Qytetit në Tetovë. Sipas Andreas, të punësuarit e spitalit kanë kryer dy vepra penale, përkatësisht: (1) shkelje të barazisë së qytetarëve dhe (2) keqpërdorim të detyrës dhe kompetencave zyrtare. Parashtrësja u dorëzua sepse në prill të vitit 2011, me udhëzim të mjekut të familjes, Andrea u përpoq të vizitohej nga një psikiatër në spital. Me të mbërritur në spital, rojet e sigurisë e larguan me forcë nga ndërtesa, duke e shtyrë atë nëpër shkallë. Ekziston një video ku është regjistruar kjo gjarje dhe e njejta u transmetua në TV Sitel. Kallëzimi penal u hodh poshtë nga prokurori publik, me shpjegimin se veprat e denoncuarat nuk paraqesin vepra penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Pas refuzimit, Andrea pranë Gjykatës Kushtetuese të RM-së ngriti padi private dhe avokati i saj filloi një procedurë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në lidhje me këtë akt diskriminues të prokurorit. Pas parashtrimit të akuzës private, gjyqtari të cilit iu caktua çështja, shprehu mospajtim për caktimin e seancës kryesore. Mospajtimi u përcoll në Këshillin Penal të Gjykatës Themelore në Tetovë, i cili, nga ana tjetër, morri vendim nëpërmjet të cilit gjyqtarit gjykues iu dha urdhër që të pranojë padinë, me theks se bëhet fjalë për një formë më të rëndë të veprave penale, ekzistenca ose mosekzistenca e të cilës duhet të provohet në procedurë gjyqësore. Gjatë seancës së parë të mbajtur në korrik të vitit 2012, gjyqtari gjykues, duke vlerësuar se padia kishte të bënte me persona të panjohur, e ktheu çështjen në procedurë hetimore. Lidhur me këtë pengesë më të re nga ana e gjykatësit, Andrea e informoi Kryetarin e Gjykatës Themelore nga i cili u morr përgjigje se është hapur një lëndë përmes së cilës do të hetohet sjellja e gjyqtarit. Nuk u dërgua njoftim nëse hetimi kishte përfunduar dhe nëse ishin vërtetuar parregullësi në punën e gjyqtarit gjykues. Sidoqoftë, për çështjen, e cila ishte përsëri nën hetim, pasi përfundoi e njejta, materialet iu dorëzuan gjyqtarit të gjyqimit, i cili përsëri shprehu mospajtimin e tij. Këshilli Penal vendosi që nuk ekzistonte vepër penale. Vendimi u ankimua në Gjykatën e Apelit, e cila la në fuqi vendimin e Këshillit Penal.

Me këtë vendim, çështja tek ne përfundon, por Komiteti i Helsinkit e mbikëqyr këtë çështje që nga fillimi i tij dhe është seriozisht i brengosur për procedurat dhe sjelljen e Spitalit të Qytetit dhe organeve gjyqësore në Tetovë. Kjo është arsyeja pse Komiteti, së bashku me avokatin e Andreas, po e përgatisin çështjen për ta paraqitur para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg, për shkelje të nenit 3 - Ndalimi i torturës, nenit 6 - E drejta për një procedurë të drejtë gjyqësore dhe nenit 14 - Ndalimi i diskriminimit sipas Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Republika e Maqedonisë ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore më 10 prill të vitit 1997.

6. Sulmet ndaj Qendrës

Në ditën e hapjes së Qendrës Mbështetëse LGBTI më 23.10.2012, ngjarja zhvillohej paqesisht, por vetëm disa orë pas përfundimit, ndodhi një sulm nga disa sulmues të maskuar, identiteti i të cilëve mbeti i panjohur. Sulmuesit thyen pjesën e përparme të vitrinës së Qendrës, duke shkaktuar dëme materiale që pamundësuan funksionimin e Qendrës për disa ditë me rradhë. Informacioni u përhap në hapësirën mediatike, por nga institucionet sundonte heshtje për çfarëdo lloj dënimi të sulmit.

Për shkak të këtyre sulmeve dhe fushatës së dukshme shtetërore kundër personave LGBTI, u riorganizua Marshi i tolerancës, i cili mbahet tani më katër vite, kurse tani, për herë të dytë iu kushtua të drejtave të grave dhe popullatës LGBTI në Republikën e Maqedonisë, të cilët u prekën nga fushata homofobike. Para fillimit të Marshit, përderisa vendoseshin tendat me material promovues nga aktivistët që ishin ende të pambrojtur, edhe pse ngjarja u raportua edhe në Qytetin e Shkupit edhe në Stacionin Policor-Beko, dy persona u sulmuan. Aktivistët e lënduar përfunduan me lëndime të lehta që ua shkaktoi një person i maskuar, i cili më vonë u arrestua.

Çështja është aktualisht në procedurë hetimore. Heshtja e institucioneve vazhdon ende, megjithëse sulmi mund të interpretohet si shkelje e të drejtave themelore të njeriut, shkelje e së drejtës për shprehje të lirë dhe të drejtës për tubim publik.

Më 17.12.2012, ndodhi një sulm tjetër ndaj ambienteve të Qendrës Mbështetëse LGBT dhe u bë një përpjekje e pasuksesshme për ta djegur atë. Sulmi u denoncua në polici. Një nga sulmuesit e Qendrës e kishte filmuar vehten në kamerën e sigurisë së Qendrës, në përpjekje për ta thyer atë, kështu që të gjitha materialet iu dorëzuan policisë, nga e cila pritet një hetim cilësor dhe veprim i mëtejshëm.

7. Mediumet

Nga lajmet në lidhje me komunitetin LGBTI, të botuara në medime gjatë vitit 2012, mund të konkludojmë se janë akoma me qasje diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI. Në vend të promovimit të vlerave demokratike, përfshirjes dhe luftës kundër diskriminimit, shumica e artikujve të botuar nga mediumet në vitin 2012, tregojnë qartë stereotipizimin negativ, paragjykimet, qëndrimet homofobike dhe një ndarje të qartë të medimeve në anti dhe pro-LGBTI. Është shumë i vogël numri i mediave që përpiqen të paraqesin imazhin e vërtetë të përjashimit shoqëror dhe diskriminimit me të cilin përballet çdo ditë popullata LGBTI në RM, duke kontribuar kështu në ngritjen e vetëdijes publike dhe përfshirjen sociale të grupeve të marginalizuara.

Shumica e artikujve të paraqitur nga mediumet, janë lajme nga jashtë. Këtu përfshihen raportimet mbi paradat e homoseksualëve që janë mbajtur nëpër botë, raportet senzacionale për figura nga jeta publike, që më së shpeshti bazohen kryesisht në supozime dhe thashetheme, me një theks në orientimin seksual të një personi. Disa nga tekstet e botuara flasin për atë se cilat qytete janë më të mirat ose më të këqijat në botë për popullatën LGBTI, artikuj që flasin për homoseksualitetin midis kafshëve dhe në të njejtën kohë bëhet një paralele me homoseksualitetin njerëzor. Disa nga tekstet përfshijnë gjithashtu tema që flasin për praktika seksuale midis njerëzve të gjinive të ndryshme, por që lidhen me praktika seksuale tipike për homoseksualët. Në botime të këtilla, mediumet që në fillim të tekstit distancohen se teksti nuk ka lidhje me homoseksualitetin, me çka praktikatat seksuale midis personave të së njejtës gjini vendosen në një kontekst negativ ose përjashtohen plotësisht si një mundësi. Personat transgjinorë përmenden më së shpeshti në tekste për konkurset e bukuri, ndërsa problemet dhe diskriminimi me të cilat përballet kjo popullatë çdo ditë, injorohen plotësisht. Interseksualët janë plotësisht të panjohur ose të përjashtuar nga hapësira mediatike maqedonase dhe nuk përmenden askund.

Nga lajmet nga rajoni dhe situata e popullatës LGBTI në Maqedoni, ndarja e mediave lidhur me këtë çështje është më se e dukshme. Mediat raportojnë në mënyrë selektive, trajtohen vetëm çështje të caktuara të personave LGBTI, ndërsa çështjet thelbësore në lidhje me pranimin e personave LGBTI dhe dhunën me të cilën përballet çdo ditë, mbeten pa përgjigje dhe mungojnë në hapësirën mediatike. Disa nga mediat raportojnë në mënyrë neutrale për punën e organizatave joqeveritare dhe projektet që ato implementojnë. Disa nga këto lajme përfshijnë disa njoftime për ekspozita, njoftime për promovime të botimeve dhe kërkimeve, hapjen e Qendrës Mbështetëse LGBTI dhe një vizitë në Qendrën e Mbështetjes LGBTI nga diplomatët dhe ambasadorët e huaj. Si një mjet shumë i fuqishëm në krijimin e opinionit publik, është edhe roli i mediave të caktuara në promovimin dhe mbështetjen e fushatës homofobike të Qeverisë, e cila filloi me ngritjen e çështjes së martesave homoseksuale nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale Spiro Ristovski. Fushata filloi në një kohë kur askush nuk kishte ndërmarrë iniciativë për të legalizuar martesat e të njejtës gjini, me deklaratën e tij në të cilën ai përjashtoi plotësisht popullatën LGBTI nga "kombi i shëndetshëm" që shoqëria maqedo-

nase po përpiqet ta arrijë. Si pasojë, kishte reagime të disa organizatave joqeveritare që u botuan në mediumet maqedonase. Përveç fushatës homofobike, gazeta "Veçer" publikoi tituj pornografikë skandalozë që tregojnë në mënyrë të qartë përmbajtje seksuale që sipas nenit 193 të Kodit Penal nuk duhet të jenë në dispozicion të fëmijëve. Disa nga numrat vijues të gazetës ishin me tituj si „Vajzat me prezervativë“, „Ne duam nipër e mbesa, jo homoseksualë“ me të cilët bashkësia tradicionale martesore propagandohej si forma e vetme e bashkësisë ku mund të rriten fëmijë të shëndetshëm, duke përjashtuar çdo formë tjetër të prindërimit dhe bashkësisë. Rezultat i kësaj fushate homofobike ishin disa sulme ndaj Qendrës Mbështetëse LGBTI dhe sulme ndaj aktivistëve të të drejtave të njeriut para fillimit të Marshit të tolerancës të organizuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Mbështetjes LGB-TI. Disa faqe interneti kanë botuar disa herë rradhazi artikuj ku homoseksualiteti vendoset në të njëjtën shportë me pedofilinë dhe nekrofilinë, e të cilët nuk bazohen në asnjë argument shkencor. Temat që adresojnë çështje LGBTI futen në medime në mënyrë të rastësishme dhe shfrytëzohen për të zhvendosur fokusin nga tema të tjera, që nuk janë në favor të qeverisë aktuale dhe mediave që janë të lidhura drejtpërsëdrejti me të.

Sa i përket gjuhës gazetareske që përdoret në medime, gjithashtu shohim ndarje. Edhe pse etika gazetareske kërkon që grupe të ndryshme të emërohen me emra që janë të pranueshëm për ta, akoma, në shumë botime, përdoret termi ofendues „peder“. Akoma më i vogël është numri i medimeve që mbështesin publikisht popullatën LGBTI dhe janë të përfshirë në mënyrë aktive në luftën për të drejtat e njeriut. Bëhet fjalë për disa portale interneti që botojnë rregullisht kërkime shkencore mbi temën e seksualiteteve të ndryshme, kolumna në të cilat festohet diversiteti dhe themeli i të cilave është promovimi i mënyrave të ndryshme të jetesës.

E drejta për lirinë e fjalës shpeshherë keqpërdoret dhe keqkuptohet. Propaganda e vazhdueshme, tekstet dhe artikujt e botuar ku qartë lexohet senzacionalizmi, stereotipet, madje edhe qëndrimet homofobike dhe diskriminuese janë të kundërta nga etika gazetareske. Duke qenë se mediumet luajnë rol kryesor në krijimin e perceptimit publik për grupet e pakicave, rezultati i një atmosfere të tillë mediatike është shkatërrimi i dinjitetit dhe degradimi i një popullate të tërë nëpërmjet të krijimit të një imazhi të shtrembëruar të saj, rritjes së frikës dhe paragjyqimeve ndaj komuniteteve të marginalizuara, rritje të homofobisë dhe diskriminimit dhe mosrespektimit të të drejtave themelore të njeriut të personave LGBTI.

Mediumet janë po aq përgjegjëse dhe të përfshirë në krijimin e një shoqërie të dhunshme dhe ekskluzive shoqërore në lidhje me popullatën LGBTI.

8. Institucionet

Gjatë vitit 2012, komuniteti LGBTI në Maqedoni u përmend disa herë në deklaratat e institucioneve, me ç'rast erdhi në shprehje shkalla e lartë e homofobisë dhe transfobisë së institucionalizuar. Rastet përfshinin: reagime të përfaqësuesve të organeve shtetërore, heshtje

e institucioneve në situata ku duheshte të dënohej dhuna dhe gjuha e urrejtjes, refuzim të iniciativave për ndryshimin e ligjeve, etj. Duke filluar që nga Qeveria dhe ministritë e saj, si dhe ministrat individualë në disa raste, gjykatat dhe organet tjera shtetërore, partitë politike e madje edhe institucionet fetare, vërehet një sinergji në veprim, e cila rezultoi në një fushatë të organizuar homofobike që ishte më intensivja në katërmujorin e fundit të vitit.

E gjithë fushata rezultoi me disa sulme fizike, si mbi mjediset që i shfrytëzon komuniteti LGBTI, në rastin konkret, Qendrën e Mbështetjes LGBTI, ashtu edhe mbi vetë lirinë e shprehjes, bashkimit dhe tubimit paqesor, që arriti kulmin në Marshin e tolerancës, më 17 nëntor 2012. Heshtja e institucioneve, pas sulmeve, vuri në dukje faktin se komuniteti LGBTI nuk merr mbrojtje nga institucionet, përkatësisht të drejtat dhe liritë e tij nuk mbrohen njësoj si të drejtat dhe liritë e qytetarëve të tjerë.

8.1 Qeveria dhe ministritë

Viti 2012 provoi të ishte një vit i rradhës i vazhdimit të politikës së gjertanishme të partisë konservatore në pushtet. Për shkak të pikëpamjeve të saj, orientimi seksual dhe identiteti gjinor ende nuk e kanë gjetur vendin e vet në legjislacion, kurse deklaratat e ministrave ishin në përputhje të plotë me pikëpamjet e partive të tyre, në vend që të ishin në interesin e qytetarëve të këtij shteti.

Fushata homofobike e lartpërmendur filloi në gjysmën e parë të tetorit, kur Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, Spiro Ristovski, duke dhënë një deklaratë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të fëmijës - vajzë, filloi të shprehte pikëpamje që nuk kishin të bëjnë me këtë ditë, por që drejtpërsëdrejti i referoheshin popullatës LGBTI, veçanërisht temës së martesave të të njejtës gjini dhe birësimeve të fëmijëve në këto martesë. Deklarata e tij pasqyroi pikëpamjet e partisë së tij, se martesë është një bashkësi midis burrit dhe gruas dhe nuk do të ketë lëshime përderisa partia e tij është në pushtet. Ai gjithashtu deklaroi se as që dëshiron të diskutojë për birësimin e fëmijëve nga çiftet e të njejtës gjini, me që është i mendimit se një fëmijë duhet të zhvillohet dhe të rritet në mënyrë të drejtë, pra në një martesë në të cilën do të ketë nënë dhe baba në kuptimin e vërtetë dhe biologjik të fjalës. Për shkak të kësaj deklaratë, e cila nuk është përjashtuese vetëm për personat LGBTI, por edhe për të gjitha format e tjera të familjes, si për shembull prindërit e vetëm dhe fëmijët e tyre, fëmijët në bashkësi jashtëmartesore, fëmijët e adoptuar, fëmijët pa prindër, etj., ndodhi një ortek reagimesh nga një numër i madh subjektësh, ndër të cilat, përveç përfaqësuesve të tjerë të institucioneve shtetërore, si për shembull Ministrja e Brendshme, reagues edhe shoqata pensionistësh, shoqata të punonjësve socialë, disa organizata të shoqërisë civile, shoqata sportive dhe individë, etj. Reagimet e shoqatave të qytetarëve që punojnë me komunitetin LGBT, në medime u nxorrën nga konteksti dhe u prezentuan ndryshe, gjë që vetëm përforcoi përshtypjen negative që tashmë e kishte opinionin i gjerë, si rezultat i fushatës homofobike.

8.2 Gjykatat

Raste të pashembullta u gjetën në gjykatat maqedonase, për faktin se kanë të bëjnë me person transseksual, duke pasur parasysh se legjislacioni maqedonas edhe më tutje nuk përmban ndonjë dispozitë për këtë pjesë të popullatës. Gjegjësisht, në rastin e parë, pas disa përpjekjeve për të marrë shërbime shëndetësore në institucionet shëndetësore shtetërore, personi u dëbua me forcë, për të cilën ekziston një video incizim si provë.

Gjithashtu u ngrit edhe kallëzim penal, të cilën prokurori publik e hodhi poshtë, duke thënë se veprimet e denoncuar nuk paraqesin vepra penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Pas refuzimit, personi ngriti një padi private, kurse avokati i palës, para Gjykatës Kushtetuese të RM - së inicoi procedurë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në lidhje me këtë akt diskriminues të prokurorit. Pas parashtrimit të padisë private, gjyqtari të cilit i ishte caktuar çështja, shprehu mospajtim për caktimin e seancës kryesore. Mospajtimi u përcoll në Këshillin Penal të Gjykatës Themelore në Tetovë, i cili, nga ana tjetër, morri vendim nëpërmjet të cilit gjyqtarit gjykues iu dha urdhër që të pranojë padinë, duke theksuar se bëhet fjalë për një formë më të rëndë të veprave penale, ekzistenca ose mosekzistenca e të cilës duhet të provohet në procedurë gjyqësore.

Gjithashtu, gjatë procedurës, u vu re mungesë e dispozitave ligjore që do të përcaktonin se në cilin burg do të vendoseshin personat e dënuar transgjnorë, përkatësisht ata që nuk kanë ndryshuar ende numrin amë. Gjithashtu, në një rast tjetër, u konstatua se gjatë marrjes së aktvendimit, përkatësisht përcaktimit të shumës së gjobës për mospagimin e kompenzimit për fëmijët, nuk ishte marrë parasysh statusi i personit transgjnor. Në fakt, gjykata nuk ka marrë parasysh se personi nuk ka mjete financiare, pikërisht për faktin se nuk mund të gjejë punë për shkak të statusit të tij, i cili nuk është i rregulluar për arsye të mungesës së rregulloreve për personat transgjnorë në R. e Maqedonisë.

Një rast tjetër i pashembullt po shqetëson opinionin gjyqësor. Gjegjësisht, fjala është për dy gra nga Maqedonia që kanë lidhur martesë të të njëjtës gjini në Belgjikë, por që po divorcohen dhe me këtë rast duhet bërë ndarja e pasurisë që gjatë martesës e kanë fituar në Maqedoni. Prona, përndryshe, i përket vetëm njëres grua, kurse sipas ligjit, pas divorcit, prona u ndahet bashkëshortëve. Por, ligji maqedonas për martesën dhe familjen e njeh vetëm martesën midis personave të gjinive të ndryshme, dhe nga ana tjetër, Maqedonia ka nënshkruar marrëveshje me Belgjikën për pranimin e ndërsjellë të dokumenteve, kështu që është e detyruar të pranojë dokumentet dhe të veprojë. Në Gjykatën Supreme është dorëzuar kërkesë për të vendosur se në cilën gjykatë do të zhvillohet procedura për ndarjen e pasurisë së përbashkët të fituar në martesë.

8.3 Subjekte të tjera

Homofobia, në mënyrë intensive ishte e pranishme edhe në organet e tjera shtetërore, si dhe në shumicën e subjekteve politike. Si shembull mund t'i marrim deklaratat e Kryetarit të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, Dushko Minovski, i cili jep deklarata kundërthënëse²⁴; nga njëra anë ai vetë tregon qëndrim diskriminues, kurse nga ana tjetër e shfaq haptazi koordinimin që ekziston midis veprimit të Komisionit për Mbrojtje nga diskriminimi dhe pushtetit ekzekutiv, baza e të cilit shprehet në pikëpamjet personale. Sigurisht, Komisioni nuk mund të funksionojë si organ i pavarur edhe për arsye se z. Minovski njëkohësisht është i punësuar edhe në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Komisioni ka vepruar lidhur me parashtresat në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në bazë të „karakteristikave të tjera personale“ dhe „seksit dhe gjinisë“, por tregon qasje selektive, veçanërisht kur parashtresat kanë të bëjnë me pushtetin ekzekutiv.

Partitë politike shfaqin pikëpamje të ndryshme në lidhje me këtë temë. Pas fillimit të fushatës së organizuar homofobike, partitë deklaruan se janë kundër martesave të të njëjtit seks dhe birësimit të fëmijëve në këto martesë.

Nuk pati asnjë reagim individual rreth sulmeve ndaj Qendrës LGBTI dhe aktivistëve të Marshit për tolerancën, përveç partisë RDM (Rilindja Demokratike e Maqedonisë) e cila dënoi sulmin ndaj Qendrës LGBTI dhe u shpreh kundër gjuhës së urrejtjes dhe përhapjes së homofobisë, e njëherit bëri thirrje për tolerancë.

Një deputet nga Partia Liberale opozitare u përpoq të rrisë ndërgjegjësimin e autoriteteve publike dhe institucioneve për distancim nga gjuha e urrejtjes dhe fjalimi diskriminues, duke paraqitur në Kuvend Deklaratë për dënimin e gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBT. Fatkeqësisht, Kuvendi nuk e miratoi Deklaratën e propozuar sepse nuk mori mbështetjen e duhur nga partia në pushtet.

9. Bashkësitë fetare

Institucionet fetare (KOM, Bashkësia Fetare Islame dhe Kisha Katolike) edhe më tutje i mbajtën qëndrimet e veta të vitit 2011 dhe rikujtuan nismën e tyre për ndryshime të nenit 40 të Kushtetutës, ku martesë do të përcaktohej si bashkësi midis një burri dhe një gruaje. Kjo nuk është ndërhyrja e parë e bashkësive fetare në funksionimin e një shteti laik. Pas fushatës qeveritare, edhe ato u shfaqën me gjuhe urrejtjeje të llojit të vet, duke folur për përkufizimet e tyre për vlerat morale dhe duke i promovuar ato si vlerat e vetme korrekte, duke përhapur homofobi dhe duke ofenduar një popullatë të tërë në deklaratat e tyre.

24 <http://www.dnevnik.com.mk/?ItemID=7311962888940F43AB0B46F3AD6A94C5>

- Fushata homofobike që filloi para hapjes së Qendrës LGBTI u krijua për të zhvendosur vëmendjen e opinionit nga problemet reale, e njëherit për shtimin e urrejtjes ndaj popullatës LGBTI. Ishte i dukshëm harmonizimi i qëndrimeve ndërmjet institucioneve, partive, bashkësive fetare, medimeve dhe organizatave civile. Mediumet luajtën rol të madh në këtë proces, duke përcjellë në mënyrë të shtrembëruar deklaratat e aktivistëve, që çoi në tensionimin e mëtejshëm të atmosferës.

KOMITETI I
**HEL SINKIT**
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKES SË
MAQEDONSË